

ARISTOTEL MICH

GJOLI I ROSAVE

85H-32

M 70



85H-32
1770

S

ARISTOTEL MICI

Gjoli i rosave


(Tregime)

2670

~~FLP/4~~

SHKURTËJA E SHKËMBIT
SHKËMBIT

SHTËPIA BOTUESE «NAIM FRASHËRI»



MOTIVE TË REJA

GJOLI I ROSAVE

Ka dhe s'ka gjahtarë ana e detit, po si Ndini s'ke ku gjen më të mirë. Me të marrë nishan ai, gjahu bie pa dalë flaka nga çiftja.

Kur zënë dhe tregojnë në fshat historitë e Ndinit hap veshët dhe dëgjo. Nuk them se s'merr vesh nga pusia që i zihet çakallit, apo nga gjahu i dhelprës e i lepurit; ai po deshi di t'i kapë të gjalla dhelprat e dosballat, po gjahu i rosës i pëlqen mbi të gjithë.

— «Ç'më duhet mua dhelpra me lepurin, — thoshte — do të bredhish tërë ditën për të zënë një dhelpër, gris një palë opinga për të vrrarë dy lepuj. Nuk është punë ajo, kurse rosa, ore tunjatjeta, të vjen vetë në grykë të çiftes, kur ti rri në ushez e përgjon.»

Pa lëre kur shtrëngon dimëri e Gjoli i Rosave mbushet dinga sa nxiron cipa e ujit. Ti qëllon një herë, dy herë; vret pesë a gjashtë e gjoli oshëtin nga përplasjet e krahëve e nga fluturimet e shpendëve.

Rosat e egra s'janë aqë budallaçka sa të mos e kuptojnë gjahtarin, po Ndinin, që është regjur me to, s'e ndjejnë dot.

Dhe në mes të shiut dhe të erës andej e gjen Ndinin, nëpër kënetë, me gishtin në këmbëz e me sy

në gjah. Merr një kalë a një gomar dhe e fut në gjol, për të ngrënë truskë a çol. Hajvani i shkretë, kur bie në ushqim, as e ndjen Ndinin të shtrirë mbi kurriz. Po ku ta dish dhe në e kupton, i duket se e përkëdhel Ndini, ose po e çon drejt kullotës më të mirë. Po jo or jo, Ndini s'ka hallin e hajvanit. E merr me të mirë që të futet drejt e në tufën e rosave të cilat zhuzhuresin me potere. Rosat tek shikojnë hajvanin e s'dallojnë dot Ndinin — «Asgjë me rrezik» — thonë. Kur shpezët nuk e presin fare, çiftja e Ndinit gjëmon mbi kokat e tyre si rrufe. Të llahtarisura shpezët ngrihen lart batore, duke u përplasur njëra me tjetrën; atëhere gjëmon fisheku tjetër. Përmes flakës së çiftes Ndini sheh të bien të vrara dy - tri rosa të tjera. Atë çast era e barutit e deh Ndinin. Ai zbret si kunadhe nga kali dhe shkon e mbledh të pesë rosat, të cilat ende përpëliten. Gjahtari i lidh këmbë për këmbë e del nga gjoli i rosave për në breg, ku i vë flakën një zhuke, ndez çibukun e shikon gjolin e fshatit të tij.

Afër shtrihet kënetat e Laçanit si një det që mezi ta zë syri.

— «I vogël është Gjoli i Rosave në krahasim me kënetën, po gjahun e ka më të madh. Kot e kanë që lodhen gjahtarët pojanakë në kënetën e madhe. Është e thellë ajo, të ndjen rosa që atje tej» — fliste me vete sikur llafosej me çibukun.

Nga pas ndjeu hapa njeriu, ktheu kokën dhe pa Ndonin, i cili me një krah mbante çikëzën dhe në tjetrën një trastë të madhe me peshq.

— Ç'do t'i bësh gjithë atij peshku, o t'u mbylltë dera — foli Ndini.

— Po ti ç'do t'u bësh gjithë atyre rosave — pyeti Ndoni.

Peshkatori si u ul, drodhi një cigare e tha:

— Mirë që e bëmë gjahun, po si ta shesim.

— Besa — tha Ndini — fshati ta blen thuajse falas.

— Jo more, ç'fshat? Do të shkojmë në pazar — tha Ndoni.

— Po s'jemi më në kohën e brigadier Kolit. S'ndreqet puna më me brigadierin e re. Lundron me dy gisht ujë ajo — tha Ndini.

— Ashtu është ajo, vërtetë e vret lart. I thashë unë njëditëzaj: «Shoqe Drita, dua të vete deri Fier se kam për të shitur ca peshk». «Uh — m'u përgjegj — kësaj i thonë të vesh në Berat për një masat».

— Me një fjalë s'të la — pyeti Ndini.

— Jo ore jo, s'të jep lejë ajo. Hiqe nga mendja lejën ti — tha Ndoni — Po di ç'bëjmë ne? Lëmë sa të lëmë në shtëpi e ja hipim atij kamioni që vjen nga Povelça.

— Ashtu do të bëjmë, ashtu — foli Ndini. Të dy u ngarkuan dhe muarën rrugën.

— Ankoheshim kot për brigadierin e parë, Koli ishte shpirt - njeriu — tha Ndoni — S'prishte qejf ai.

— Qe burrë, more vëlla. Merreshe vesh me të.

— Për punë pazari mua s'më pati penguar asnjëherë — foli Ndini.

— Edhe s'e bënte vetem të mbante sytë nga duart. Në i jepje vetë, të thosh «falemnderit», nuk i jepje, s'thosh gjë — tha Ndoni.

— Kjo është dhe fare firifiu nga mendja, more Ndoni vëllai. Më gjeti mua një ditë këtej anës së

Gjolit, kur po shkante me gjeometrin e më pyeti:

— «Ç'mendon ti, xha Ndini, për Gjolin e Rosave? Ç'mund ta mbiellim, po ta thajmë?»

— Si i the, o Ndini, më qafsh!

— Do ta mbiellim çol e jamruk të ngjallim hajvanët —iu përgjegja.

— Jo, xha Ndini, jo — më tha — ne do ta mbiellim oriz.

— Mirë moj shoqja Drita — i thashë — oriz mbilleni — se do t'u vejë në gju të breshkës.

— Ha, ha, ha, ha — ç'ja paske bërë.

Në këto e sipër ata ishin futur në fshat. Çanga po binte me të madhe e njerëzit po linin punën. Dielli si një sofër e kuqëremtë përflaku Gjolin.

— Ore, po ju pse s'vini në arë si të tjerët, po i bëni bisht punës? — u tha bariu i lopëve.

— Ku ka punë tashti në ara ore, je në vete!

— Si ore, s'ka? Shokët e tjerë hapën brazda kullimi nëpër të lashtat. Disa u muarën me grumbullimin e plehut.

— S'janë punë për ne ato — tha Ndoni — jemi moshë ca si e shkuar ne tani.

— Të rinj s'jini, po edhe pleq s'mund t'ju themi, siç është xha Mitrush, që s'e le lopatën nga dora.

— Ti ha bukën tënde dhe bën llogarinë e botës — i tha Ndini.

— Ç'do të bëni kur të thajmë Gjolin? — tha bariu.

— Është puna jonë, ty s'të duhet gjë.

Pa e zgjatur me bariun, të dy gjahtarët muarën rrugën drejt qendrës së fshatit gjithë krenari, në vend që ta ulnin shpinën nga pesha, ata e ngrinin kokën më lart.

Kur u ndanë, e bënë me fjalë që të nesërmen, sa të lente dielli, të dilnin në rrugën e Povelçës dhe të shkonin me kamionin e bonifikimit në qytet.

Ndonëse dukej i qetë, Ndinit i rrihte mendja te ajo pyetja e bariut «Ç'do të bëni kur të thahet Gjoli?»

Ky mendim zjente gjithandej në fshat e kishte ardhur deri në gojë të loparëve e të dhenarëve.

Sapo vinte në shtëpi, fëmijët e rrethonin Ndinin e kush e kush t'ja hiqte nga krahët rosat. Gjahtari ngrohte duart e u tregonte:

— Kjo është rosë ngake, se bën ngak, ngak, ngak. Kësaj i thonë fishkëllemzë se bën fiu - fiiiu. Atij atje i thonë kredharak se kridhet.

— Po ky? — e pyeste një fëmijë.

— Ai është rosak jeshilës, se e ka kokën të gjelbër.

Ndini Marini vërtet dukej pak i kërcur në çështje gjahu, po për punët e fshatit s'e bënte dysh, kurrë s'rrinte pa marrë pjesë. Në mbledhje nuk mungonte asnjëherë. Sidomos ditët e fundit po i mbante veshët hapur. Sa herë dëgjonte për mbledhje, zemra i ndillte keq për Gjolin e Rosave. «Hej ç'do të na e heqin nga duart dhe atë pellg uji — thoshte me vete — s'kemi për të parë këmbë rose».

Një mbasdite, një të ardhur nga puna, mori ciftën dhe u nis për gjah.

— «Ta shkrep një herë tashti para se të perëndojë — tha — pa në darkë është e vështirë, bëhet mbledhja e përgjithshme».

Qëndroi një orë Ndini, po shpezët nuk po afroreshin. Kishin të drejtë rosat e egra; në kullotën afër bregut ato vinin mbas perëndimit, kur delte hëna, jo kur delte ai. Në atë kohë ato kullosnin në

mes të Gjolit. Më kot rrinte në ushez, duke pritur, si i thonë, shih me sy e plas me zemër. Rosakët, si për zili të tij, atje në thellësi përplasnin krahët, larin trupin e bërtisnin: ngak, ngak, ngak. I dukej gjahtarit sikur i thoshin: «Ndini, ç'do të na bësh...?» Zemra e shtynte Ndinin të merrte buallin që kullos-te aty anës, ta fuste ngadalë në ujë e t'u drejtohej rosave pas bishtit të tij, kurse mendja e ndalonte: — Jo, i thoshte, ke mbledhjen e përgjithshme».

Hunda po i çahet për një çibuk duhan. Më në fund e ndezi dhe si e kuptoi se nata do të ishte e larë nga drita e hënës, tha «mos u bëj merak moj hundë, se edhe erë baruti do të thithësh»...

Kur u fut Ndini në sallë, hodhi sytë rreth e rrotull, kërkoi Ndonin dhe, si e pa, iu ul pranë.

Sekretari i organizatës së partisë foli pak dhe shkokuqur.

«Kënetat e Hoxharës dhe ajo e Laçanit së shpejti do të thahen. Kanalet e mëdhenj, që do të çojnë ujërat në hidrovorin e Polvelçës, janë duke mbaruar. Në përfundim është vet hidrovori. Tashti ka ardhur koha të mendojmë edhe ne në fshatin tonë për Gjolin e Rosave. Është fjala për kanalet. Si thoni, kemi mundësi t'i bëjmë vetë?»

Ndini dhe Ndoni po bisedonin njeri me tjetrin.

Një i ri, që sa kish ardhur nga ushtëria, mori fjalën:

— Mendoj se s'ka prit të presim. T'i përvishemi punës menjëherë e të hapim kanalet.

Ndini tundi kokën dhe tha me vete:

— Hajde mendje, hajde! Janë në vete këta apo kanë lajthitur?»

Pastaj u ngrit brigadierja e re, Drita. Ndoni mblodhi buzët dhe i tha Ndinit:

— As kur vjen në mbledhje nuk i heq pantallonat kjo.

— Na u bë burrë e shkuar burrit, po e ka një dërrasë mangut ama. E di ç'më tha pardje kur u ktheva nga pazari? Ti, shoku Ndini, je pas me realizimin e ditëve të punës.

— Lëre mos e zgjat — ja priti Ndoni.

Të dy ata bisedonin si miza në qyp, ndërsa Drita fliste me zë tingëllues.

— «Për hapjen e kanaleve është mirë të fusim sa më parë gjithë forcat e lira tani sa nuk kanë filluar fushatat. Dobia do të jetë e madhe. E para, shtojmë tokën e bukës dhe e dyta, do të rrisim prodhimin.

Ndonit më s'ju ndejt, po u hodh si ajo përca në zjarr:

— Hë shoku Ndoni, ç'keni për të thënë? — u dëgjua kryetari.

— Më duket mendje e papjekur kjo gjë. Në vend që ta pleqërojmë punën mirë, po marrim mendjen e rinisë dhe po e nxisim të ikë zdrënkthi. Kur kemi toka plot, pse të lëmë fuqitë tona në kanalet e gjolit? Fundja nuk jemi dhe të babëzitur për tokë, por nevojtarë për krah pune. Pse të kullojmë djersë në gjol për pëlhurë marimange?

— Pse, nuk e kupton dobinë e kësaj pune, ti, shoku Ndoni? — pyeti dikush nga të rinjtë.

— Dobinë e kuptoj, po s'kam të qartë se qysh u thakërka ky Gjoli i Rosave, që edhe inxhinierët e kanë thënë se është nën faqen e detit, andaj s'mund të hapim kanale; po i hapën do t'i biem kokës me grusht, se do të na futet deti brenda.

— Qysh mendon ti se mund të thahet? — pyeti Drita.

— Unë mendoj se ai thahet, po ta mbathësh. Ja, kemi mundësi të sjellim barkun e malit të Tomorrowrit e ta shpërndajmë këtu nepër gjol? Jo, atëhere s'ka mundësi tjetër.

Zëra njerëzish u ngritën në sallë. E para që e kundërshtoi qe Sofa:

— Kur u thaka kënetat e Laçanit që s'ka anë e fund, si s'paska mundësi të thahet Gjoli i Rosave? Po shoku Ndoni pështyn në gjellë, se ka hallin e peshkimit me çikës dhe të interesit personal.

Në mbledhje foli edhe Ndini, i cili, ndonëse i binte fyellit në një vrimë, u duk në fillim sikur s'qe i një mendimi me Ndonin.

— Nuk është ashtu si thotë Ndini. Gjoli i Rosave mund të thahet. Po, dhe në u thaftë kam frikë se do të na vejë mundimi për dhjam qeni. Se edhe në u thaftë, s'bëhet tokë buke. Vetëm fshesa kripje për arixhinjtë prodhon kjo tokë. Kështu që ne do t'i gëzojmë ata dhe asgjë tjetër.

— Po plehërat kimike, pse i kemi?

— Do ta kullojmë!

— Do ta mirosim me pleh organik — dëgjohe-shin zëra nëpër sallë.

Ndini ngriti një dorë pak lart e sikur deshte t'i kërcënonte njerëzit me çibukun e tij. Fjalën e mbylli duke thënë.

— Në tokën shëllirë, fara kripë ka për të mbirë. Nuk mbarset mushka të pjellë mëz.

Mbas një jave, piketimi i kanalit kryesor kishte mbaruar. Fshatarët u sulën të gjithë me vegla në duar. Kush me bel, kush me lopatë ose me kazmë. Vargu i njerëzve u bë i gjatë. Në mes të të gjithëve, atje ku ishte puna më e thellë, shquante Ndini me takijen në majë të kokës. Vërtetë që ai ka ca huqe


dhe takijen ndryshe nga të tjerët e kaq po nuk është Ndini fare veç nga bota. Atë ditë ai punonte bashkë me brigadieren Drita. Sa më shumë nxitonte Ndini me bel, aq më tepër u jepte duarve brenda në kanal Drita. Ai bot ta linte pas, ajo bot të mos i ndahej me lopatë duke qëruar dhe duke pastruar dheun që binte nga beli. Punonte me sa fuqi kishte Ndini dhe mendja i vinte te fjalët e Sofës, që tha në mbledhjen e përgjithshme: «Ndoni e ka hallin te interesi personal». Këto fjalë e dogjën, sa s'i dilnin nga mendja.

Pas disa ditëve kanali kryesor që zgjatur në një pjesë të mirë të gjolit. Mezhdha e tij e hedhur mënjanë gjante si një gjarpër vigan, që do të pinte ujët e kripur të kënetës. Atë ditë një pjesë e kooperativistëve po merreshin me pastrimin e vendit nga do të shkonte kanali. Kishte tek-tuk disa marina dhe zhuka, të cilat duheshin hequr se pengonin punimet. Ndini i njihte mirë gjithë marinat e atij vendi; ato ai i kishte si ushez natyrale. Nëpër ato ushez prej marine Ndini pati kaluar sa e sa orë duke pritur rosat e egra e duke thithur çibukun. Në fillim Ndini e mori si lodër hapjen e kanalit. I dukej se njerëzit po bënin shaka, i vinte sikur ata do të largoheshin nga puna, se do ta quanin gjë pa vlerë. Po kur filloi prerja e marinave, gjahtari e kuptoi mirë se kaqë e pati dhe gjoli i tij.

— Po deshe, mund të shkosh të presësh marina — i tha Ndinit një djalosh që e kishte aty pranë.

— Jo, jo, se nuk e kam në rregull bishtin e sopatës — tha Ndini.

— Mos të ngeli qejfi — tha Drita — të themi të vesh andej, sepse ajo është punë më e lehtë; me hapjen e kanalit do të merret rinia.



— E di që është më lehtë andej, po s'para e kam në rregull sopatën.
Kur dëgjuan këto fjalë të Ndinit, të rinjtë ho-

dhën sytë nga sopata e tij, që kishte ngulur majën e tehut mbi një trung marine dhe rrinte gatitu. Në të vërtetë ajo e kishte bishtin në rregull, po vetë Ndini s'para ndjehej mirë. Tek shikonte moshatarët e tij, Sifin dhe Jotin, që prisnin marinat pa pikë mëshire, atij i pikonte në zemër dhe i ngjante se po i thyenin kondakun e çiftes.

Sifi i bërtiti që atje tej:

— Ec o Ndini, ec dhe çmally për të fundit herë me marinat e tua.

— Do të punoj me rininë, unë — tha ai me shaka — nuk jam si ju që kërkon punë të rehatshme.

— O po hidhja patës ti ato, jo neve — tha Sifi — siç duket nuk ta do zemra të prishësh folenë me duart e tua.

Vetëm tani e kuptuan të rinjtë pse thoshte Ndini: «Nuk e kam në rregull bishtin e sopatës». Kishte ardhur dreka. Të gjithë u ulën të hanin bukën me ç'kishin marrë me vete. Pasi u ngopën me bukë e pinë dhe ujë me bucela, të rinjtë ja muarën këngës. Një i ri e zinte dhe një vajzë ja mbante:

Të shohim tokat e reja

«Të dalim nga Myzeqeja,

Ku punojnë vashat e reja»

Të gjithë bënë iso eeeee, kurse Ndini lundronte midis tingujve të këngës drejt kohës së ardhme. Gjoli i përfytyrohej i tharë, çiftja e ndryshkur. Rosat, po ta gjenin vendin të tharë fare, do të iknin andej nga Karavastaja, ose në gjolin e Nartës. Kur u ngritën, një vajzë e pyeti:

— E xha Ndini, si thua, do ta mbiellim oriz pas tre vjetësh, apo jo?

— Tallabak i keq kjo tokë, plot shëllirë, e vështirë është të bëhet tokë e mirë.

— E vështirë, po jo e pamundur — u dëgjua një tjetër.

— Ashtu si dëshironi ju u bëftë. Fundja unë s'jam profit, që të vulos.

Puna valonte e kënga zjente.

Kaluan që atëhere disa muaj. Kur u lëshua hidrovori i Povelçës, kanalet e Gjolit të Rosave qenë bashkuar me kolektorin. Hidrovori thithte ujërat e kripura si një përbindësh me gjashtë gojë e ja dërgonte detit me gurgullimë të potershme. Si u shter mirë gjoli, bujqit i derdhnin ujë Vjose me anë të kanaleve vaditës. Ujët e ëmbël të Vjosës, si qëndronte një kohë, shpëlante sa shpëlante tokën nga kripa dhe dërgohej në det me anë të kanalit kullues. Kjo punë u bë në verën e parë. Pastaj shirat e vjeshtës dhe të dimërit e shpëlënë fare gjolin. Kur erdhi pranvera njerëzia lanë mendjen me Gjolin e Rosave. E ç'të shikonin! Në vend të jamrukut dhe të fshesës kripje, doli e gjelbëroi një farë kashte që u bë dy bojë njeriu.

— Ndini ndërroi mendim, ujërat ndërruan rrjedhë, po rosat nuk ndërruan rrugë. Të trembura nga oshtima e hidrovorit të Povelçës shpendët e egra vinin dhe strukeshin përditë dhe më tepër në gjol.

Këtë donte dhe Ndini që kishte gjetur dhe një palë çizme gjahtari deri në rrezë të kofshës.

S'kishte më nevojë Ndini të futej në tufën e rosave pas bishtit të buallit. Për të paskesh qenë stisur kjo botë e ky gjol edhe tashti pas tharjes. Kanalet u bënë të thellë dhe mezdhat aq të larta sa që Ndini s'kishte pse të ecte aq i kërbunjur, vetëm sa ulte pak qafën, sa të mos i dukej maja e takijes.

Doemos puna e gjahut e kërkon që njeriu të

shtrihet për të marrë nishan, po ku pyeste Ndini se mezhdat ishin akoma të reja dhe të bënin me baltë, mjafton të gjente gjahun, pa shtrihej si në kashtën e mullarit.

Pas dy vjetësh i gjithë gjoli gjelbëronte edhe më shumë nga kashta fryjtje.

Pa nisën njerëzia të korrin kashtën dhe të bëjnë rrogoza. Kishte nga ata që s'qenë mësuar me këtë punë, po Ndini ua kthente si të qe më i qarti nga të gjithë.

— Si ore s'u dashka kashta? Si ore s'u dashkan rrogozat? Me se do t'i mbulojmë kasollet? Po fidanet e domateve të hershme me se do t'i rrethojmë në ditë thëllimi?

Edhe pse fliste kështu, gjetkë i rrihte mendja Ndinit. Ai kishte hall të korrej sa më parë kashta, që të mos i humbisnin rosat nëpër të.

Në pranverën e vitit të tretë, pas kanalizimit, toka e Gjolit të Rosave qe mirosur aq shumë, sa fshatarët s'po u besonin syve.

Dheu qe mbrujtur aq mirë, sa kur u futën plugjet e parë, kridheshin si në bukëvale.

Pas plugimit me traktorë u futën pendët e qeve.

— Brumë, o Ndini, brumë qenka e shkreta — tha një pendar.

— Fundi do të gjykojë — tha si me shpoti bariu i lopëve — se mos hedhim farë e na bëhet kripë.

— Ik, or ti, thyej zverkun tutje — i bërtiti Ndini.

— S'e kam me ty, — i tha bariu.

— Shiko veten tënde se mos të humbasin lopët si herën e parë. Sa për mua, thua ti, humba gjolin, po fare pa gjë s'mbeta, se fitova kanalin.

Ishte ditë e kthjellët. Si një perde e bardhë midis dy gardhesh me pisha dukej godina e hidrovorit

LIBRARI E SHKENCËS
GJORGJI

51914

e pas tij shtrihej cipa kaltëroshe e detit, prej nga vinte bashkë me oshëtimën e hidrovorit një erë e lehtë pranverore, që përkëdhelte kraharoret e pendarëve të parë. Gjithë atë ditë të kthjellët, tok me tingujt e zileve dhe me zërat e fazanëve, u dëgjuan edhe fjalët e pendarëve.

— Hë, kazi.

— Prapë balash, tokë e butë ore, si bukëvale — harapash. Para pendarëve ishte skuadra e atyre që pastronin tokën nga drurët e fundit. Duheshin hequr dhe ata drurë, sepse bënin hije dhe dëmtonin bimët.

Aty pranë sokëllinte sëpata e Ndinit, që qëllonte me sa fuqi kishte mbi rrënjët e një verriut. Ai godiste me vrull dhe tek priste rrënjët e fundit të verriut, i dukej se po priste dhe disa fije të padukshme në thellësi të kraharorit. Sa më shumë priste ato fije, aqë më të lirë e ndjente veten, aqë më afër pendarëve, aqë më tepër i ngjante vetja si bujk e si shok.

DAVIDHI

Ati i Davidhit, Pilo Poçja, u martua i ri dhe barkun e pati të mbarë. Fëmijët ja dëgjonin fjalën që të nëntë. Është i fortë nga trupi dhe i bëshëm nga krahët; me gojë pret hekurin. Kur qëllon të grindet me plakën, i thotë: «Në shtëpi këndon gjeli dhe jo pula», «Patat bëjnë ç'bën patoku».

Djemtë e parë i martoi si e donte radha. Për këtë gjë Pilo Poçja ndjehej i lumtur. Gëzimin e tregonte tek flinte në atë krevatin e fortë prej furkash druri, të cilin e kishte bërë vetë atje nën hijen e fiku. Kush e shikonte të flinte në atë krevat, të dehur nga zëri i bilbilit, thoshte se bota ishte e tij. Po kohët e fundit s'qe tamam ashtu, sepse dhe atij i kishte ngecur çomoga në arrët. Mendimet i shkonin verige nën takije. Dhe kjo për shkak të atij djalit të vogël, Davidhit, që i doli haram, si nuk e mendonte. Atë ai e pati zënë në bisht të jetës. Davidhin e mbante për bastun të pleqërisë, po i doli ndryshe. Nga të nëntë fëmijët e xha Pilos, Davidhit i takonte radha në fund. Ai e kishte kohën përpara. «Tashi për tashi s'dua nuse nga Davidhi unë, po shkollë» — përsëriste i ati. Davidhi mësimin e kishte në thua, andaj sillte çdo vit bashkë me dëftesën fletëlavdërimi. Pilos i bëhej qejfi dhe mburrte djalin: «I fundmi i fëmijës, bastuni i pleqërisë». Si

mbaroi mësimet në teknikumin e naftës, Davidhi nisi punën në Patos. Bëri dy vjet jetë beqari. Pas dy vjetësh të tjera, me t'u kthyer nga ushtria, u fut teknolog në Azotik në repartin e krekëngut, ku zbërthet nafta për të dhënë hidrogjenin. Atëherë kur ai sapo kishte filluar të njëzet e tretin vit, u miqësua me një vajzë teknologe. Së fundi u dashuruan dhe ndjeheshin të lumtur. Po Davidhi duhej të priste radhën; ai kishte dhe tre përpara, andaj e mbajti një vit e ca të mbyllur dashurinë, sa asnjë s'e mori vesh nga fshati. Po shokët e uzinës e kishin kuptuar. Jo më kot i kishin thënë Davidhit: — «Shko te reparti i ndarjes së ajrit dhe na merr një kovë dëborë».

— Ç'na duhet dëborë?

— Në këtë vapë korriku nuk na u dashka dëborë! Ja ore, na duhet të ftohim aranzhatat.

— Më mirë po shkoj t'i çoj atje aranzhatat.

— Sa të bëjnë këmbët për atje, i varfëri ti — i tha teknologu më i ri — ruaju se mos të qëllon me dëborë ajo Tefta.

Pa asnjë druajtje vajti Davidhi te impianti i Teftës: «Punë e madhe në e kanë kuptuar ata — thoshte me vete — shokët e mi janë; më tepër se një vit nuk ke si e mban të fshehur».

Po ndërsa ai ruhej, fjala kishte marrë erë deri sa erdhi në vesh të Pilos.

— Paska qenë thëngjill i mbuluar — kishte thënë Pilua — tani që e dëgjova ja rregulloj unë samarin atij.

U nis Pilua drejt e në Azotik. U ul mbi një stol nën hijen e një plepi e po priste sa të dilnin punëtorët. Më në fund ja zunë sytë të birin, kur ishte

duke ngrënë akullore me Teftën. Të dy të rinjtë hanin akullore e përkëdheleshin me sy.

— «Ja tek qenka kokëderri» — tha plaku me vete — Ja dhe flokëprera, që i ka marrë mendjen. Pse, more bir? Ç'të duhet ty kjo me pantallona? S'është ajo për shtëpi. Në vend që ta urdhërosh, ajo të urdhëron. Sikur nuk kemi vajza të ndershme në fshat ne. Çupa që s'të kthejnë fjalën, e nuk shikojnë njeri në sy.

Davidhi e njohu të atin që atje tej nga takija.

— Ik shpejt — i tha Teftës — mos të na shohë babai bashkë.

— Ku je, ore Davidh, ku je. M'u bëre kaçak fare. Kemi dy muaj pa të parë. Na bëre merak.

— Kemi pasur shumë punë në uzinë, baba — tha djali.

— Punë, punë, po dhe njerëzit e shtëpisë nuk harrohen.

— Të shtunën në darkë do të vij, atë ditë marr dhe rrogën.

— More çun, s'jemi keq për rrogën tënde ne — i tha Pilua — po për ty. Ruaju mos na shket në drrasë të kalbur!

Sa shkëmbyen këto fjalë, erdhi autobusi.

— Ec të hipim, baba!

— Hip ti — i tha plaku — unë kam lidhur gomarin te një mik aty në Zhukan. Do të iki që këtej nga kodrat, se më ha gjatë andej anës qytetit.

Në mbrëmje Pilo Poçja vajti te Joti Xhunga, i cili kishte pasur gjithnjë këmbë të mbarë për lajmësi. Si e dëgjoji Pilon, Joti i tha:

— Nuse për Davidhin të gjen vëllai ty.

— Ma kupton hallin si e kam unë?

— E marr me mend se ç'njeri kërkon ti — tha

prapë Joti. — Së pari ti do një vajzë që të mos kthejë fjalë, të mos shikojë njeri në sy, të mos të tundet nëpër mbrëmjet e vallëzimit; së dyti të jetë e vogël që të presë sa t'i vijë radha Davidhit.

— Të lumtë goja — foli i kënaqur Pilua — kë-shtu ma gjete zemrën.

— Pastaj edhe bukurinë nuk do ta lëmë pas dore fare — tha Joti.

-- Për bukuri s'pyes unë. Unë pyes për derë e për nder. E bukur është edhe dëbora, po e shkelin qentë — fliste me qetësi Pilua.

— Vajzë, si e kërkon ti, ka Gori Kashta prej Rredhit — tha gjithë krenari Joti.

— Vërtet është shtëpi e ndershme, gjithnjë mirë kam dëgjuar për fisin e tyre — shtoi tjetri.

Joti Xhunga, i cili në fshat mbahej si njeri i prerë për lajmësira, edhe kësaj mblesërie iu vu me të gjithë mjeshhtërinë e vet. Për të marrë pëlqimin e Gori Kashtës nuk e pat hiç të vështirë. Puna pothuaj ishte e mbaruar, vetëm pritej të vinte Davidhi.


— Ku do të gjejë më mirë Davidhi — thoshte faqe botës Joti Xhunga — e ndershme po, e urtë po, e vogël po.

— Mirë e ke ore lajmës, po frikën e kemi të madhe, se mos e ka hedhur në lak ndonjë tjetër — i tha vëllai i Pilos.

— Do ta sqarojmë dhe ai do ta kuptojë se ne të mirën e tij duam. Kush ja do atij të keqen këtu.

Kur i thanë Davidhit të shtunën në darkë se Joti Xhunga i kishte gjetur për nuse të bijën e Gori Kashtës, ai i tha me përçmim:

— Kot është munduar Joti të më gjej mua nuse, sepse unë e kam gjetur vetë.



— Kur s'ke radhën, qysh e paske gjetur vetë?
— i bërtiti babai.

— Po ju si ma paskeni gjetur, kur nuk e pas-
kam radhën?

— Dëgjo, o David, dëgjo, — foli urtë e butë
Joti — do ta mbajmë ashtu të fshehur nën rrogoz,
sa të vijë radha, pastaj fët menjëherë e nxjerrim në
shesh. Ti vetëm sa të japësh fjalën.

Djali e shikoi me përbuzje lajmësin e i tha:

— Nesër në mëngjez do të përgjigjem.

— Kur të duash, ore bir, vetëm të bindesh që
për të mirën tënde jam munduar.

Në mëngjez herët, para se të nisej për në Azotik,
Davidhi kishte shkruar me shkronja të mëdha një
fletë rrufe, të cilën e vendosi në qendrën e fshatit.
Me dhjetëra njerëz gajaseshin, tek lexonin vargjet:

*Joti Xhunga, Jot Mavria
S'hoqi dorë nga lajmësia.
Bën fejesa si të dojë,
Ndonjë send të përfitojë.
S'e di ky lajmës i vjetër
Se erdhi një ditë tjetër??
Është turp që shoku Joti
Kërkon të rrojë si qëmoti.*

* * *

Tërë atë javë Pilua me Jotin nuk u dukën në
fshat. Kastile që të mos dëgjonin gojët e botës, ikën
për të gjuajtur peshk në Povelçë.

— Nuk ta pata borxh, o Pilo — tha lajmësi.

— U rrit fëmija, u prish shtëpia, o Joti, nuk e
kanë thënë kot të parët këtë fjalë.

— Më vutë bojën e zezë në fytyrë para fshatit.

— Na e bëri i paudhi, ore Joti, po hasha ta bëj të mbrapshtin.

Kështu e kalonin kohën të brengosur të dy pleq-të andej nga bëset e Povelçës, duke mbajtur veshët kthyer nga fshati, për të dëgjuar se ç'do të pëlciste më keq.

— Prite tani kur të na nxjerrin dhe në karikatürë — thoshte lajmësi.

— Pse, ç'të keqe bëmë ne? — pyeti Pilua.

— Sepse ashtu i bën mendja vezë rinisë, atyre shokëve të Davidhit tënd.

— Davidhi iku në Azotik, nuk vjen më — tha Pilua.

— Nuk është nevoja të jetë ai tani, Davidhi sa vuri shkrepshen, pa zjarrin i fryjnë të tjerët. Prite kur të na nxjerrin dhe në estradë!!

* * *

Një mbrëmje, mbas një viti e ca dashurie Tefta i tha Davidhit se kishte ndjerë sinqetësime dhe duhej të bënin martesën. Tetë muaj pas celebrimit ajo lindi djalë. Fëmijën e regjistruan në gjendjen civile me emrin Aleksandër. Djali, që sapo doli nga veza mbi dhe, u bë i njohur në tërë fshatin. Për të flisnin plakat tek pinin kafe, graria në pus, ose burrat nga tymosnin. Vetëm gjyshi nuk deshte të dëgjonte për Aleksandrin. Në ja zinte veshi atë emër, tundte kokën si shenjë zemërate për të birin e ndërkyer.

« — Jo vetëm prishi radhë e zakon, por mori dhe nderin nëpër këmbë që e zuri djalin andej ferrave. . . » — përsëriste herë pas here Pilua. Kur çuni i ferrave, siç i thoshte ai, u rrit dhe ikte në këmbë, Pilua do të martonte djalin e shtatë. Kishte kaluar një kohë prej afër dy vjetësh dhe Davidhi s'kishte

shkelur në shtëpi. Për të s'e vriste aqë mendjen plaku. «Atë kokë pati, atë feste vuri» — mendonte.

Një të parë krushqit me nusen, xha Pilua nxori çiften dhe shtiu nga një herë me secilën grykë. Me krushqit në rrugë rasësisht qe bashkuar dhe Davidhi me nusen e tij dhe me djalin e vogël.

Tek puthi nusen e re dhe u mat të piquej me kryekrushkun, xha Pilos i pruri kunata e tij një djalë.

— Mbaje dhe këtë, është djali i djalit, Aleksandri — i tha ajo.

Qetë - qetë xha Pilua e mori fëmijën në krah, dhe, si nxori një ofshamë, diç foli me vete për djalin e pleqërisë, Davidhin, që nuk e kishte në këtë dasmë. Më shumë se mungesa e tij në dasmë, atë e shqetësonte shkaku që ai e zuri djalin ferrave duke prishur nder e zakon; plaku këtë e kishte gozhdë në zemër. Me djalin në krah ai u fut në dhomën e miqve. E vuri në prehër dhe fërkoj sytë. Era e barutit të çiftes i ngacmonte hundën, e fuste në kujtime të largëta të kohës, kur ishte gjahtar i ri, të asaj kohe kur kishte pëlqyer një çupë, që s'ja dhanë. Po pse ky kujtim i vjetër iu shfaq tani që ai mezi po përtyppte gabimin e Davidhit? Pse tani? Pastaj ai kujtimi i largët i dashurisë së tij të parë i iku tutje në thellësi dhe i mori me vete çdo brengë.

— Të thoshja, o Pilo, të thoshja — u dëgjua kryetari i qoshes — se çuni i ferrës bëhet trim kaçak i derës.

— Ndërroi bota, po nuk ndërrokemi ne — iu përgjegj Pilua.

— Ne nuk ndryshojmë, po nuk hoqëm ndryshkun — foli prapë kryetari i qoshes.

Mbesat e Pilos erdhën dhe ja muarën djalin e

vogël, kurse ai vetë, me t'u ngritur, kapi një këngë të vjetër dashurie:

*Vjen thëllëza anës lumit,
Duke i dhënë gushën pëllumbit;
Vjen thëllëza anës malit,
Duke i dhënë gushën djalit.*

Një shok i moshës së tij ja mbante, të tjerët bënë iso: eeeee. Në mes të atyre që bënë iso ishte dhe Davidi.

DEMI LARUSH

Ku të ishte dëmi më i madh, Larushi atje e ngulte turinë më i pari. Ku të ishte shtegu më i largët, atje i vinte syri Larushit. Veç mos t'i vidhej nga syt loparit se e dinte vetë ku e mbante frymën: në ballin e grurit ose në mes të misrit.

Larushi, si dëmtar që ishte, qe dhe i regjur me zarare. Shkopinjte, që kishte ngrënë, e kishin bërë të nxite aqë mend, për t'u futur sa më fshehur e më në mes të arave. Megjithëse qe bërë dem, huqet i kishte si viçoku mëzor.

Kështu arrakat i mbrapsht qe Larushi sa kohë që e ruanin fëmijët. Po më vonë, kur e mori në dorë xha Trifoni, erdh e u shtrua, sa të bënte zemra ta shikoje kur kulloste, aqë urtë rrinte, pa le që mori boj e shëndet. Brinjët nuk i dukeshin më nga dhjami, sharra e kurrizit iu mbush e vithet iu rrumbullakosën si kombisht, aqë sa ta shikoje do të çuditëshe:

— Larushi i xha Trifonit është ky? — do të thoshje.

Ashtu si u bë i butë e i urtë demi, ashtu erdh e u zbutën të zotët me të. Ku të ishte maja e barit më e mirë, për Larushin do ta ruanin. Bënte ç'bënte xha Trifoni dhe thoshte me vete: «Ngopu, o Larush, ngopu dhe trashu deri në fund të verës. Atëherë ty

do të lë në pazar dhe në vendin tënd do të marr një lopë me viç dhe ai viçi ka për t'u bërë dem si ti». Kështu mendonte plaku e tek përfytyronte vadhin plot me lopë dhe duart plot para, iu kujtua statuti i kooperativës.

«Hëëë, hëë — ja bëri xha Trifoni me vete duke buzëqeshur prap nën mustaqe — statuti kufizon lopët ose dhentë si krerë, po jo qingjat dhe viçat. Rritu dhe trashu ti, o Larush, po parave që do të më japë pazari yt, di t'u gjej vendin unë. I kthej në shtjerra, që i shes pastaj shelegë, ose i bëj viça e i shes sa të bëhen dema si ti.» Duke bërë këto ëndërrime, xha Trifonit i erdhi në mendje një fjalë e moçme: «Gjëja e gjallë të mban gjallë, vetëm me të të zë paraja paranë.»

Në këtë mënyrë arësyetonte me vetëveten ai atë mbrëmje kur u nis për në mbledhjen e asamblesë së kooperativës. Në mbledhje u shtruan shumë çështje të rëndësishme. U fol për grumbullimin sa më të shpejtë të të lashtave të fundit, për ujitjen dhe për misrin hamullor.

Foli dhe sekretari i organizatës së partisë:

— Shokë! Për sonte — tha ai — është menduar nga ana e organizatës së partisë të merret në analizë inisiativa e kooperativistëve të Gorishtit në lidhje me dorëzimin falas të viçave meshkuj. Inisiativën e tyre e ka gazeta e pardjeshme. Jini dakord? — pyeti.

— Po — thanë të gjithë.

— Tashi dëgjoni se do t'jua lexojë agronomi — tha kryetari i kooperativës.

Si u lexua gazeta, të parët që e morën fjalën ishin komunistët. Ata të gjithë përkrahën inisiativën e Gorishtit. Kur fjalët muarën zjarr, xha Trifoni

hoqi takijen, kruajti zverkun dhe e vuri prapë në kokë.

Vendi sikur s'po e mbante; ai donte që kjo mbledhje të mbaronte sa më parë; po kur ja, pa prituri kryetari i tha:

— Po ju, o xha Trifon, ç'mendim keni?

Xha Trifoni që zakonisht fliste ulur, kësaj rradhe u çua në këmbë si për t'ua mbushur mendjen të gjithëve.

— Edhe unë jam i një mendjeje me shokët e Gorishtit dhe me ata që folën këtu që viçat meshkuj t'ja falim kooperativës. Unë të kisha viç mashkull, pa asnjë ngurrim do t'ja falja kooperativës.

— Ke, ke mashkull.

— Ke Larushin — thanë disa gra.

— Të bësh çudi jini ju gratë! — bërtiti xha Trifoni — Pse ma merrni fjalën nga goja? Larushin tim e njohin të gjithë në mëhallë dhe e dinë se ai është dem dhe jo viç.

— Për kooperativën është aq më mirë që e ke dem — tha një nga ata të presidiumit.

— E po inisiativa e Gorishtit s'thotë për dema, po për viça.

Kur xha Trifoni po mundohej t'i bindte njerëzit, disa burra shtrembëruan buzët, për të mbajtur të qeshurën, kurse graria ja dhanë me të madhe. E qeshura mori flakë tallas - tallas, po xha Trifoni bëri sikur nuk u nxe dhe e fshehu inatin nën mustaqe.

— Shikoni — tha prapë — ta kisha viç Larushin, për atë shën-Gjergj, do ta kisha dhënë.

Sa nxori fjalët «shën-Gjergj» xha Trifoni, gazi u ngrit në qiell e s'kishte të përmbajtur. Më kot

mundoheshin shokët e presidiumit të vinin rregull. Kishte edhe që qeshnin me lot.

«Në vend të vija vetulla, nxora sytë» — tha me vete xha Trifoni dhe nisi prapë për ta sqaruar fjalën e tij.

— Më është mësuar goja me shenjtorë, more shokë, po jo që besojmë, se po të qe vërtet shën-Gjergji lart, pse i la të rinjtë të prishnin kishën?

Lili, i biri i Trifonit, kur e pa se i ati u bë gazi i botës mori leje te presidiumi dhe u çua të fliste.

— Vërtetë që babai është i madhi i shtëpisë, po për demin Larush nuk do të pyetet vetëm ai. Unë mencioj se ne nuk do të bëjmë ndryshe nga të tjerët. Ne do të bisedojmë edhe një herë në shtëpi e kam besim se do të merremi vesh që ta dorëzojmë Larushin me pëlqimin e të gjithëve.

Ndërsa Lili fliste kështu, xha Trifoni thoshte me vete: «Po, ke të drejtë, se e kam rritur unë, kam shpuar duart unë nëpër ferra e therecke të mblihdja barishte për të. Po mirë thonë: «Mall babai, gjë që s'të dhimbet.»

Atë darkë xha Trifoni nuk u ul fare në sofër. Një të ardhur në shtëpi, shkoi e u shtri në krevatin prej drurësh anës kasolles së bagëtisë, ku kishte vënë kashtë në vend të dyshekut. Si ndenji aty për një copë herë, i shkrepri një mendim në kokë dhe shkoi t'ua thoshte të tjerëve, që po piqnin misra të njomë përreth zjarrit.

Pa u ulur mirë akoma ai foli:

— Ju keni vendosur ta dorëzoni Larushin, ja ta zemë se edhe unë nuk po u dal prag, po sikur unë vdiqa nesër, pasnesër (se i ri nuk jam) ku do t'i gjeni ju paratë për harxhe dhe për varrin tim?

Lili më s'ja mbajti përgjigjen po i tha:

— «Ti të rrosh, o baba, pa në vdeksh, ne nuk shpresojmë të të nderojmë me paratë e Larushit, po me krahët tona.

Për një kohë zotëroi heshtja. Pastaj secili shkoi të flinte.

Të gjithë i zuri gjumi, përveç xha Trifonit. Të nesërmen gdhinte dita e dielë, ditë pazari. Plaku bënte plane për t'u nisur në pazar sa më herët me Larushin për dore, që ta shiste.

Kur kishte nisur të fekste atij iu bë sikur djemtë kishin ardhur aty në kasolle, ku flinte ai në verë, për të marrë fshehurazi tij Larushin. Ai u ngrit dhe qëllloi dikë me bastun. Njeriu që u shtri, qe i biri. Xha Trifoni vuri duart në kokë dhe bërtiti:

— «Bobo! Ç'bëra! Bobo! Ç'bëra!»

Po me të hapur sytë e kuptoi se kishte qenë në ëndërr. Tronditja iku, po gjumi më s'e zuri. U nis atë mëngjez shpejt pa u ndjerë nga djemtë. Kur vajti në qendër të fshatit, pa edhe disa të tjerë me vija në duar drejt pazarit.

— «Ja, paska dhe të tjerë, nuk qenkam vetëm» — tha me vete. Pastaj nuk iu ndjet pa e pyetur njërin:


— Pse po e shet vëcin, o Leko?

Lekua iu përgjegj:

— Po e shes, o xha Trifon se e kam femër dhe dua të blej një viç mashkull në vend të kësaj, me qëllim që edhe unë të ndihmoj në shtëmin e pendëve të kooperativës.

Xha Trifonit nuk i tingëlluan mirë në vesh këto fjalë dhe bëri sikur s'e kuptoi.

— S'jam vetëm unë — u dëgjua prapë Lekua—



të gjithë ata që po shkojnë me vija femra, duan t'i bëjnë ato meshkuj në pazar. Po ti xha Trifon ç'pobën me Larushin?

Plaku, që e ndjeu veten ca ngushtë, tha:

— Ja, do ta kullos pak anës ugarëve.

Ndërsa pazarakët shkonin përpara, xha Trifoni ngeli në rrugë kryq, e lidhi Larushin te një degë marine e i hodhi një krah të vogël me bar të njomë. U ul mbanë rruge me këmbët në hendek, ndezi çibukun me masat dhe filloi të pinte i kredhur në mendime. Kur tymi i duhanit po i trazohej në drejtime të ndryshme dhe megjulla po largohej përherë e më shumë, ai pa se disa bujq të tjerë me vija meshkuj në duar shkonin në drejtim të kundërt me të, vinin andej nga stallat e kooperativës, për të dorëzuar vija të tyre.

Njëri nga ata e pyeti si me shpoti:

— Pse po qëndron në rrugën kryq, o xha Trifon? Nga do ta çosh Larushin?

Plaku u mbloodh në vete dhe heshti. — Pastaj i tha demit:

— E Larush, si do të bëjmë? Nga do të vemi? Ku të pëlqen? Në stallën e kooperativës apo në pazar?

Demi që po ripërtypte ushqimin, nguli sytë drejt të zot e u duk sikur tha: «Gjëja e mirë nuk del nga fshati». Po xha Trifonit prapë nuk iu ndejt: «Në fshat, në fshat, po kooperativa s'të paguan».

Vija meshkuj që po shkonin drejt stallës pëllisnin «muuu-muuu» sikur ndillnin njëri-tjetrin.

Larushi, duke pandehur se vija të thërrisnin atij, ktheu kokën dhe palli edhe ai «muuu, muuu».

Në këtë pallje të demit, xha Trifonit i ngjante

sikur shprehej një ankim; atij i bëhej sikur Larushi u thoshte vëçave të tjerë më të vegjël:

«Dua të vij edhe unë me ju, po ç'ti bëj tim zoti!».

«— Mirë, o Larush, mirë, në kooperativë dashke ti, atje të çoj unë. S'ta prish babai ty. Po shiko se mos më turpërosh. Të jesh më i zoti nga të gjithë» — i thoshte plaku demit.

Larushi luante kokën, për t'i shpëtuar shtrëngimit të kapistrës në mënyrë të atillë, sa plakut i dukej se ai thoshte: «Po, po, mos ki merak». Xha Trifoni e mori veten dhe ngriti kryet lart. Sytë i vajtën te shtëpia e tij e re, e cila ndrinte nga gëlqerja, pastaj pa edhe shtëpinë e vjetër, që tani përdorej si kasolle për bagëtinë. Ai u nis drejt stallave, bri për bri me Larushin, të cilit ja kishte hequr kapistrën. Ja kish hequr se kish pasur frikë mos i dridhej dora, kur ta fuste në vadhin e madh. Si ja dorëzoi demin stallierit, i ra një herë nga vithet e i tha:

— U bëfsh për qerre dhe për parmendë!

— Të lumtë goja! — i thanë stallierët.

* * *

Ditën bënte si bënte xha Trifoni, po në mbrëmje, tek shikonte bosh vendin e Larushit, mendja s'i largohej prej tij. Dashuria për demin tulatej e qetësohej gjatë ditës, po natën ajo zgjohej, i ngacmonte zemrën, i largonte gjumin ashtu si gjëmbi i thereckës në mish. Për natë i shfaqej hija e Larushit. Herë e shikonte të uritur, herë të lodhur, herë të shpuar me hosten. Nga dashuria dhe nga malli për të ai s'linte ditë pa e parë. Edhe pse kaluan disa javë, xha Trifoni nuk ja ndan sytë Larushit. Ndonëse punon si roje bostani, ai kujdeset për demin,

që tashi u bë ka, si ndonjë stallier i dytë. Kur gjen gram të njomë dhe tërfil të pastër, plaku ja çon Larushit fshehur nga qetë e tjerë, fshehur nga stallierët. Ata, duke parë se larushi nuk e hante të gjithë ushqimin, u shqetësuan për shëndetin e tij, po u vinte dhe çudi: nga njëra anë Larushi ishte më i shëndetshmi i qeve, nga ana tjetër ai hante më pak. Për këtë arsye një ditë atë nuk e mbryen në zgjedhë. Brigadieri kish lajmëruar veterinerin. Me të ardhur specialisti, stallierët e çuan te Larushi. Si e vizitoi me kujdes, veterineri tha:

— Unë s'i gjej ndonjë dobësi, gjendja shëndetësore e kaut është normale.

Xha Trifoni e fërkoj nga krahët veterinerin dhe i tha: «Të lumtë goja, or doktor, Larushin e ka rritur kjo kockë».

— Po këta shokët na thonë se nuk ha ushqimin.

Atëherë plaku u shkri së qeshuri e u dha mustaqeve të drejta tel një fërkim me të prapmen e dorës e tha:

— Prandaj qenkërki munduar! Po pse ore, dhjetë barqe ka ai? Një bark ka të shkretën. Se, ta merrni vesh ju bijtë e mi, Larushi nuk ha vetëm ato që i hedhin stallierët, po edhe ato, që i mbledh xha Trifoni. Kështu foli, duke treguar me gisht një kapiçë me bar të freskët. Pastaj ai i ftoi të prisnin një shalqi në llogari të tij. Kur ikën të tjerët, plaku u fut prapë në bostan e mendonte: «Mirë që e mbledh barin në ovradet e bostanit, po pse ai jap vetëm Larushit? Sikur vetëm ai është imi! Të gjithë janë të mitë, të gjithë janë tanët!»

Që nga ajo ditë ai nuk ushqente me barin e mbledhur në bostan vetëm Larushin, por të gjithë demat e tufës së re.

K R I S T I N A

Kristina, pasi shpërndau forcat e brigadës në vendet e punës, u nis për te sera. Rrugës, anës gardheve shikonte brazimën që kishte rënë natën. Mendja i vinte te domatet e mbjella. Kalkani në hendeqe qëndronte i fortë e reflektonte diellin e zbetë si pasqyrë. Kur Kristina po hiqte një copë baltë nga tutat blu, pa se nga rruga anës gardhit dolën dy gjahtarë. Njëri ishte kryellogaritari dhe tjetri Liu Coli, që kishte qenë brigadier.

— Ju paska vajtur mbarë gjahu — u tha brigadierja.

— Me këtë të ftohtë u verbohen sytë rosave dhe të vijnë vetë në grykë të çiftes — ja ktheu kryellogaritari.

— Pisk do ta kenë domatet e tua — i tha Liu për ta ngacmuar.

— Ju kujdesuni për gjahun e rosave, pa për domatet e eksperimentit kujdeset gjithë rinia e brigadës.

— Kur kanë ndër mend të piqen ato? — pyeti Liu.

— Nga marsi — u përgjegj kryellogaritari në vend të përgjigjeje Kristina.

— E po kësaj i thonë të hash thana në shën-Ndre or vëlla.

— Do të bëhen ato, ore Liu — i tha me ironi kryellogaritari — se do të piqen me zor nga furnella e vajgurit.

— E po do të jenë të lezeçme pastaj si kërpudhat në hi foli me të qeshur Liu, që kishte qenë brigadier i Kristinës.

— Ju më mirë përpiquni për rehatinë personale dhe për kënaqësinë tuaj se për eksperimente nuk duhen njerëz si ju — u tha vajza.

— E po ta pret mendja, lipsen shkencëtarë — foli me romuz Liu.

Ata shkuan për në shtëpi me rosat e vrara në krah, kurse Kristina u nis për te sera, atje ku kanali bënte një kthesë e formonte një bërryl.

Me të vajtur, ajo shoi furnellën, hoqi kashtën si dhe rrogozin që kishte vënë mbi polietilen.

Rrezet e diellit vërtetë ishin të ftohta, po kur futeshin te sera e ngrohnin ajrin e brendshëm më shumë se shullëhu. Tek po rregullonte vijën kulluese anës serës, nga dritarja e zyrës e pa llogaritari Rako, i cili kishte kohë që i pat vënë syrin Kristinës. Rakos i pëlqente kjo vajzë për sytë e saj ngjyrë lule çikore të mëdhenj e me bisht, e pëlqente për flokët e arta e të prera shkurt, për trupin e lidhur dhe për zgjuarësinë.

— «Kjo është tamam qytetare — thoshte ai — më vete mua në çdo gjë. Po të shkoj prapë në qytet, më ka hije një nuse si Kristina.»

Rakua kishte qenë disa vjet në qytet kur punonte si llogaritar në një ndërmarrje. Me të zënë vend në qytet, ai nisi ta heqë veten si shumë të mësuar.

Për t'u dukur njeri qyteti, ai ndërroi dhe em-

rin. Nga Rako e ktheu Rafael. Kohët e fundit Rafaelin e zuri burokracia dhe ai iku nga ndërmarrja në fshat. Këtu prapë gjeti vend në llogari. Nuk e bënte kurrë veten si njeri që kishte qenë i tepërt në ndërmarrje.

— «Erdha vullnetarisht në fshat unë, nuk më zuri burokracia — thoshte gjithnjë Refati.

Me të ardhur te sera i thirri vajzës:

— Kristinka, qenke kthyer herët nga arat.

— E do puna, Rako, po do të shkoj prapë. — Atij nuk i erdhi mirë që ajo i foli me emrin e vjetër Rako, e jo Rafael.

— Ngele pas këtij eksperimenti, Kris.

— O dhe ti Rako! Më plase me këto Kris dhe Kristinka. Folë ore si gjithë fshati.

— S'më bëhet të flas ashtu myzeqarçe. «Tinë, Kristinë». Më tingëllon më bukur evropjance: Kris, ose Kristinka, si në filma.

— O po mjaft se më fryve me këto... Po s'më thua të lutem, si të duket fletërrufeja që të kanë vënë të rinjtë?

— Ajo fletërrufe është e nxituar. Unë s'kam bërë punë fizike deri tani, se kam qenë i zënë me llogarinë. Pyesni kryellogaritarin.

— Unë mendoj se duhet të të shqetësojë ca.

— Moj Kris, lëre fletërrufenë mënjanë, por të lutem më thuaj pse ke filluar teknikumin bujqësor, kurse ekonomiku është më i mirë.

— Pse qenka më i mirë teknikumi ekonomik?

— Se ka perspektivë. Bëhesh llogaritare. Vete edhe në qytet. Kurse më shkollë bujqësore ngelesh e syrgjynosur në fshat.

— Ty të paska marrë mendja erë, më duket.

— Nuk merr vesh nga bota ti, andaj flet ashtu, Kristinka.

— Jo, ore Rako, s'ndërroj unë shkollën.

— Për të mirën tënde të thashë, po sidoqoftë, po pate vështirësi në algjebër, thuamë të të ndihmoj.

— Fatmirësisht nuk e ndjej nevojën.

«Punë e ftohtë kjo — tha me vete Rafaeli duke ikur — ajo do ta këtë rregulluar me ndonjë».

Kur u largua ai, ajo lau çizmet dhe u nis për në arë, ku punëtorët e fushës hapnin brazat e kullimit.

Rrugës pa elektrikistin e fshatit, Agronin.

— Ama e mbajte fjalën e dhënë, Agron, — i tha.

— Unë akoma s'ta kam dhënë fjalën, moj Tinë.

— Goniii — i tha me përkëdhelje ajo — mos u bëj shejtan. Më the se do të ma sjellësh elektrikun te sera. Do ta bësh instalimin tani?

— Nuk e sheh se jam i zënë, do të vete te stalla e lopëve. Atje kam shumë punë. Duhet ndrequr avaria. Të bëhet lidhje e çarkut, se ndryshe pa korrent nuk punojnë maqinat mjelëse.

— Atëherë mbasditë.

— Jo, as mbasditë. Do të vete në fund të fshatit te xha Thanasi. Do t'i instaloj dritat në shtëpinë e re.

— E po kur të ikë dimri nuk e dua unë korrentin.

— Pse mërzite, moj, po në darkë. Tani s'mund të kthej rrugë.

— Kemi mbledhje sonte, — i tha ajo.

— Mbas mbledhjes, moj Tina.

— Si do të shikosh ti natën?

— Me elektrikun e dorës.
— Nuk ke frikë se të zë korrenti?
— Tina, elektrikisti është i përgatitur për ditë e për natë.

— Nuk di se si më ngjan që s'e kam vendosur rezistencën elektrike brenda në serë.

— Por ç'duhet kaqë me ngut kur ke furnellën me vajguri brenda serës?

— Sepse elektriku është shumë më i pastër.

— Kaqë tepër u dashka nxehtësia atje?

— Patjetër duhet për ditët dimërore pa diell dhe për natën.

— Po pse?

— Sepse me ngrohtësi ne krijojmë brenda mikroklimën, sjellim pranverën brenda serës të mbuluar me cipën transparente prej polietileni.

— Po ç'është polietileni?

Ajo i buzëqeshi, e kapi nga krahu i fuqishëm dhe i tha:

— Ec pra të vemi dhe do t'i shpjegoj të gjitha ç'ka eksperimenti.

Atij iu duk një gjë e këndshme ajo dora e shëndetshme në krah të tij. I ngjante se dora po i guduhte tërë trupin.

— Ika — i tha Agroni papritmas — më vajti vonë për në stallë.

— Mirë u pafshim në mbrëmje — i tha ajo pa ja hequr sytë nga shpatullat e gjera. — Dëgjo, Agron — i bërtiti nga pas, kur ai qe larguar ca. — Mos harro që t'i marrësh të gjitha veglat me vete, kur të vish në mbledhje.

— Patjetër — i foli ai me zë të qartë.

* * *

Gjatë kohës që Tina bisedonte me Gonin, Rafaeli shtrëngonte dhëmbët prapa dritares së zyrës.

— «Qenka ky elektrikisti i përdersëm shkakë-tari që s'më do mua Tina. E gënjeka ai. Kush e di, i tregon ndonjë histori sporti, i premtan ta futë në skuadrën e volibollit sa ta hedhë në dorë.» Nga inati u thirri llogaritave të tjera.

— Shikoni atë Tinën — tha duke treguar me gisht — ka lënë brigadën e po merret me punë eksperimentale me atë elektrikistin! — dhe qeshi: hi - hii - hiii!

— Pse të qeshet? — i tha një vajzë.

— Ç'do ajo me elektrikistin... Të bukur she-mbëll u dhënka të rinjve. I ka hije asaj të flasë vesh më vesh me atë?

— Ti deri dje e mburrje Tinën, ore Rako — i tha njëra.

— Rakua po e bën si ajo dhelpëra, që s'arriti të hante dot rrushin — ja priti një tjetër.

Rafaelit i erdhi inat që ato nuk e ndihmuan për thashë e theme prandaj u bërtiti me mërzitje:

— Mësoni të flisni me mua! Më quajnë Rafael e mos më thërrisni Rako.

Ato ja plasën gazit, kurse atij iu ngritën qimet e kokës përpjetë si gjëmba iriçi. Buzët e holla dhe të gjera iu shtrembëruan deri në shëmtim.

* * *

Mbledhja e organizatës së rinisë filloi pas perëndimit të diellit. Kishte ardhur dhe sekretari i partisë. Merrej në analizë puna kërkimore - shkencore. Një i ri nga brigada e blegtorisë foli për gjethen e patates, e cila, po të silazhohet me njëzet për qind

kashtë gruri, u bëka ushqim i shijshëm për lopët.
«Gjethet dhe kërcenj të e patates — tha ai — i heqim atëherë, kur tuberat nuk kanë më nevojë për to.»

Kristinës i vinte rëndë të fliste, i dukej se do të mburrej, po sekretari i partisë kërkoi që edhe ajo të merrte fjalën. Kristina u bë më e kuqe nga ç'ishte. Sytë e kaltër si të kristalta i lëshonin xixa:

— Unë po eksperimentoj rritjen e domateve të hershme në sera. Kam mbjellë vetëm gjashtë metro katrore. Ditët me diell më kanë ndihmuar për të mbajtur të konservuar ngrohtësinë edhe për orët e natës. Kur ka qenë moti i ftohtë si sonte kam ndezur furnellën e vajgurit.

— Pse nuk kini përdorur energjinë elektrike? pyeti sekretari i partisë, kur mbaroi ajo.

Në vend të Kristinës u përgjegj Agroni:

— Korrentin do ta vendosim që sonte në sera, shoku sekretar, po kemi pengesë kryellogaritarin.

— Ky eksperiment — vazhdoi sekretari — ka vlerë ekonomike dhe politike. Nuk është fjala të disa kilogramë domate, po të lindja e një ideje të re: domatet mund t'i rritim dy muaj më parë. Nga ana tjetër futja e elektrikut në sera do të jetë simboli i futjes së elektrikut në bujqësi, që do të bëjë mrekullira, që do të shpejtojë pranverën komuniste».

Kur fliste sekretari i partisë, Kristina e shponte me bërriyl Agronin e i thoshte:

— Prandaj e vonove instalimin e rezistencës elektrike në sera... paske patur frikë kryellogaritarin. S'të dija kështu... frikacak, pa kurajo.

Tek e shponte Tina, djaloshi ndjehej aqë i ngacmuar nga gëzimi, sa hutohej dhe s'gjente dot fjalë, për t'ju përgjegjur thumbimeve të saj.

— Jo, për nder — tha më në fund Agroni — s'kam patur aspak droje, po përfitova nga rasti, me qëllim që nesër të mos ketë gojë kush të të thotë ty as një gjysmë fjale.

* * *

Me të mbaruar mbledhja, elektrikisti hodhi çantën në shpinë dhe i tha brigadieres:

— Kristinë, jam gati të nisem.

— Do të shoqëroj, s'do të lë vetëm, ma jep mua elektrikun e dorës. Të dy ata humbën në errësirë, duke çarë natën me elektrik. Afër serës së eksperimentit ndodhej një shtyllë e tensionit të ulët. Agroni, para se të ngjitej mbi shtyllë, rregulloi pincën, kaçavidën dhe thikën, të cilat ishin të mbështjella nga fundi me material izolues. Si preu me thikë llastikun që vishte dy skajet e telit, u ngjit e qëndroi në një vend mbi shtyllën e trashë si qykapiku mbi dru. Atje lidhi telin fazë dhe telin nul. Kristina i jepte shpejt elektrikut të dorës që drita të mos ndërpritej asnjë çast, derisa ai zbriti në tokë. Pastaj me telat në duar vajtën në sera. Agroni pyeti:

— Pse duhet kjo mbulesë prej polietileni?

— Ta tregova në mëngjez: kjo është një cipë e tejdukshme, që lejon të futen brenda rrezet e diellit për ngrohjen e ajrit.

— Domethënë se elektrikun do të hyjë në punë kur s'ka diell dhe bën ftohtë — thoshte me vete Agroni tek po instalonte në furkën e shkurtër prizën për rezistencën elektrike. Me të shpejtë ai vendosi dhe çelësin elektrik me portallambën. I provoi me indikator dhe pa se jepnin xixa si portallamba ashtu dhe priza. Futi spinën e rezistencës në prizë



dhe vuri re që spiralja e saj u skuq shpejt. Me të luajtur çelësin, llamba u ndez. Sera e tejdukshme u bë si një ishull drite në oqeanin e natës dimërore. Tina dhe Goni brenda në sera ngjanin si figura mitologjike në mes të një kornize me dritë.

— Sa bukur! — tha Tina.

— Sa e kam ëndërruar një rast si ky! — foli elektrikisti.

Jashtë filloi një shi me pika të mëdha, të cilat trokisnin mbi polietilen si mbi një daulle me copë të hollë.

Ndonëse frynte erë dhe binte shi, të rinjtë nuk e ndjenin të ftohtit atje brenda serës. Trupi u zjente nga gjaku i nxehtë. Shumë donin të thoshin, po s'u dilnin fjalët nga goja. Buzët, që u dridheshin, u bashkuan si me magnet. Atë çast hutimi e lumturie Kristina tha:

— Me të vërtetë më do, Goni?

— Sa jetën time — i tha ai.

— S'di pse më hyre në zemër ashtu si elektrikun në sera dhe më zhyte në një det lumturie.

— Kurse mua, Tina, më vjen sikur po më dalin krah e do të fluturoj me ty midis dritave.

Me të mbaruar shiu, retë e zeza u çanë në mes e zbuluan hënën e plotë, e cila u ndriçoi rrugën të dyve, sa s'qe nevojë për elektrikun e dorës. Djali e shoqëroi Kristinën deri në shtëpi. Ata ecnin në këmbë, po u ngjante se lundronin në një liqen të bukur.

* * *

Rafaeli, sa herë që e shikonte Kristinën me Agronin, pëlçiste përbrenda prej ligësie. I shtytur prej cmire e në shenjë hakmarrjeje një ditë me shi,

kur s'dukej njeri përjashta, ai u nis të këpuste telin e korrentit që shkonte në sera. Mori një hu të gjatë me një gdhë në fund e vrapoi për te ara nga bëhej eksperimenti. Atij i dukej se, po të prishte korentin e serës, do të prishte dhe dashurinë e pastër të të dy të rinjve.

Jashtë bënte ftohtë, frynte erë me shi që të pikte fytyrën. Po Rakua çante në thëllim i ndezur përbrenda nga ligësia. Ai mendonte që, pasi ta këpuste telin elektrik, të shqepte dhe cipën prej polietileni. Ai e dinte se ata mund ta rregullonin prapë, por mjaftonte një natë acari si ajo që domatet të rrinin pa ngrohje dhe me mbulesë të hapur që të vyshkeshin, sa të mos e merrnin veten kurrë. Ai çau anës ugarit si një hije e zezë, duke shikuar me bisht të syrit se mos e diktonte njeri. Me të arritur te sera, ngriti drurin lart e deshi ta tërhiqte telin e hollë te vendi i lidhjes me gdhërin e hurit. Mirëpo sa u takua gdhëri me telin fazë, Rafaeli ndjeu një tronditje të tmerrshme, që e hodhi në tokë si kungull. Ai nuk e dinte se druri i lagur e përçon elektrikun. Mbas ca minutash erdhi në vete e u ngrit si i çmendur pa e ndjerë plagën që i kishte bërë një kallamishte misri e mprehur si thumb nga drapëri, kur qe korrur. Sa shkeli te zyrat e kooperativës, bërtiti:

— Më zuri korrenti! korrenti, korrenti! Ai e ka fajin — tha duke shënuar me gisht elektriciçistin.

— Ku të zuri korrenti? — e pyetën.

— Te eksperimenti — u përgjegjën dy vajza që e kishin parë.

Elektriciçisti me përgjegjësin e sektorit të qen-

drës vrapuan për atje. Me të vajtur te sera, panë hurin e varur në linjë.

— Mos e prek hurin — foli elektrikisti — se është i lagur. — Shiko ç'ka dashur të bënte!

— Ka kërkuar të këpuste telin, më qëllim që të sabotonte eksperimentin e Tinës — foli përgjegjësi i sektorit.

— Qenka njeri i lig — tha me përçmim elektrikist Agroni, i cili qëndroi të rregullonte lidhjen, kurse përgjegjësi i sektorit u nis në qendër të kooperativës.

Kur vajti te ambulanca, pa se Rafaelit i kishin dizinfektuar plagën me jodio dhe infermiera po i bënte gjilpërat kundër tetanozit. Ai rënkonte, ndër-sa përgjegjësi i sektorit i tha:

— Ç'ke moj zemër që rënkon, koka bën këmba pëson.

— Si ndodhi aksidenti? — pyetën njerëzit.

— Ka vajtur vetë si cjapi te kasapi — u tha përgjegjësi.

— Si është e mundur? — u çuditën të gjithë — Ç'kishte kërkuar?

— Kishte dashur të këpuste telin e korrentit për të sabotuar eksperimentin e Kristinës.

— Aaaaa! Aaa! Pastë faqen e zezë — thanë të tjerët e u larguan prej tij sikur të ishte ndonjë i sëmurë nga lebra, Infermierja vazhdonte t'i bënte gjilpërat.

Pas pak erdhi dhe Agroni. Linja s'qe dëmtuar. Vetëm polietileni i serës qe çarë një çikë. Ajo ishte një plasje fare e vogël, një dëmtim i parëndësishëm. Domatet rriteshin me ditë.

Më tetë mars bëhej dasma e Kristinës me elektrikistin. Moti ishte i kthjellët dhe paralajmëronte pranverë. Domatet e eksperimentit genë shenjuar, Që atje brenda në serën e tejdukshme ato, si nuse faqekuqe, u buzëqeshnin njerëzve që shkonin rrugës për në dasmë. Dasma bëhej në vatrën e kulturës. Në krahun e djathtë të dhëndërrit qe ulur nusja. Kënga ziente e përzjerë me tingujt e fizarmonikës. Bashkë me të gjithë këndonte dhe Kristina me Agronin. Bisedonin dasmorët për çiftin. Për Agronin thoshin se si elektrikist ishte i vetmi, se ai e bëri dritë fshatin. Për Kristinën thoshin se ishte guximtare dhe e vendosur.

— Eksperimenti i saj doli me sukses — tha sekretari i partisë.

— Elektriku bën mrekullira — foli kryetari i kooperativës.

— Po ne e penguan në fillim, i thamë se nuk ja vlen eksperimenti — u dëgjua prapë sekretari.

— Jo se nuk ja vlente, po se ishte si i parakohshëm — foli kryellogaritari, për t'i dalë në mbrojtje kryetarit.

— Më mirë thuaj se nuk donim t'i hapnim telashe vetes — ndërhyri sekretari i partisë — fjala vjen mot nuk do të mbjellim gjashtë metro katrore, po gjashtëqind. Atëherë do të prishet rehatia jonë. Do të vihemi të gjithë në lëvizje. Do të na duhen më shumë metro polietilen, tokë e mirë, pleh. Mot nuk do të luftojmë vetëm për rendimente

të larta drithi, por edhe për domate të hershme.
E pra, e shikoni se eksperimenti i Kristinës na e
prishi qetësinë, na shtoi dhe një detyrë më tepër.

Ata që s'kishin qenë dakord ulën kokën, kurse
të tjerët vazhdonin këngën:

*«Të shkëlqente djersa
Mbi faqen si ar,
O djalo, more,
Djalo myzeqar.»*

FJALOR :

lule çikore = (çikore intobus — latinisht) ka kërcenj të
hollë dhe ngjyrë të kaltër.

sera = vende të posaçme, si dhoma transparente për të
rritur domate të hershme.

polietileni = lënda prej të cilët përbëhet mushamaja trans-
sparente e serës.

I FUNDIT

A i kishte kohë që shërbente në kishën e shën — Thanasit, ndaj njerëzia ja patën harruar llagapin e parë dhe të gjithë e quanin Themi Qishari. Deri para disa vjetësh papa Zariku s'bënte asnjë hap, po të mos kishte me vete Themiun, i cili i shkonte si bisht pas hijes.

Meqë ra fjala për papa Zarik Tullën, e meqë uratësia e tij kishte të bënte me punët e Themiut, është mirë të njihemi me atë, që kishte nxirë jetën me rroben e zezë të perëndisë. Nga trupi vinte i gjatë, i mbështjellë me dolloma, që ngjante së largu si kërcu i djegur nga vetëtimia. Mjekra e përhimtë i zgjatej si rrënjë preshi dhe i mbulonte pamjen e zbetë të fytyrës, kurse gërshetat e mbledhur turrëz ia zinte kamellafi i zi. Kush ka bërë edhe pesë llafe me të, ka kuptuar se si dinte t'i jepte anën bisedës. A po s't'i lidhte gjërat me ato rrëfimet e shenjta, që i dinte si t'i kishte në majë të gishtërinjve! Kishën e meshonte çdo të kremte, pa le ato përshpirtjet e shkreta që i takonin çdo javë! Mënjanë kishte pagëzimet, më tjetrën anë kurorat. Me një fjalë urata kishte mbirë në koce të samarit të pelës dori. Ashtu si kishte punët, kishte dhe marrjen papu; mbaronte meshimin dhe

vinte në hajatin e kishës, ulej këmbëkryq e mbli-dhte ç't'i jepnin. Të dielën djersitej vërtetë, po e mbushte mësallën plot me gatime e copa të për-shpirtjeve, aqë sa mezi i vinte në pelë.

Mësalla e uratës ish më e madhja në enorije. Ajo mbante pa frikë katër kanistra me majë. Pa kur vinin të kremtet e rënda thua ti... sidozot pa-shkët... ai e dinte se sa lodhej, duke bërë atë za-konin e lutjeve të shenjta për ata shpirtërat e vdekur.

Kështu papu fitonte më shumë se qishari. Ndonjëherë, po mos t'i jepte urata Themiut të zi-josur ca nga copat e tij, ai ngelte me gisht në gojë.

Ja që kohët ndërruan: për çudi dhe fitimet e priftit u zvogëluan.

Kur nisën t'i pakësoheshin atij copat dhe meshët e grynjta, s'po i epte Themiut, as e ftonte, siç kish qenë zakoni për mot në gonetë e shënuara në fshat.

* * *

Kurrë s'e pat prishur gjakun Themi. Qe më-suar me gëzime e me hidhërime, me lot e me këngë. Vetëm këtë vit ishte nxehur ca herë dhe kjo kishte ndodhur me anëtarët e kooperativës. Një herë i zinin dhentë në dëm, një herë qetë në grurë. Pa kur i thosh ndonjë nga miqtë e tij për të bërë lu-tje e të futesh në kooperativë, atëhere ikte dhe s'i thoshte as ditën e mirë.

— Po të duan, le të ma marrin tokën; atje s'futem — përgjigjesh.

Në këto mendime të Themiut klliste hundët dhe papa Zariku,

— O i dashur Themi, qofsh i bekuar, pesë

shalqij në një sjetull nuk mbahen; po qe se fute në kooperativë, detyrën e qisharit s'e bën dot më. Ti bëj si të duash, unë kaq di të them. Këtu je si maçoku në thekër, prandaj mos luaj — bisedonin një mbasdite nën hijen e fiqve.

— Bah! Unë s'e bëj atë. Të futem në kooperativë e kur të dergjem nga reumatizma të fryj sytë pastaj. A, po mos të isha çyryk nga gjuri, futesha, bile me një këmbë, atje merr sa punon, por ç'e do se unë jam gjysmak.

— Pastaj të kujtoj se je dhe me femra. E për ne të krishterët puna e çupës është një gjë delikate. S'ka gjë më të rëndë se sa kur vajzën tënde ta urdhëron tjetri. I thonë një fjale: «Çupa po shkeli gjashtëmbëdhjetë vjet thotë: «xhan o zjarr, xhan o burrë». Zoti mos e dhëntë i shtyri syri në bela vajzës me ndonjë «farëpalënë» e ai faqeziu ta bëri ren-gun e ta la si para kallp. Apo e kam gabim? Ne llafosemi si shtëpi. I mban mend mirë besoj ato, që na tha Kozi Pyka për atë brigadierin pusht, i cili u shtonte ditët e punës çupave të bukura.

— Mirë e ke ti uratë, të paçim sa malet! Flet si duhet. Halli se unë s'po ia dal shtëpisë tej e ndanë as me një gjë. Iku koha, kur kishte qorra që të binin meshë sa ngopje pulat dhe të tepronte dhe për mua.

— E mor i shkretë, por harrove se në kooperativë je yzmeqar i tjetrit — u hodh e tha urata.

— Ta them haptas, or papu, edhe po të rri më vete kam frikë se mos nuk nxjerr dot kafshatën e gojës.

— O budalla, tashti që na vdiq psallësi, puna jote rregullohet si s'ka më mirë. Ne s'kemi nga të

gjejmë tjetër psallës. Kështu do të marrësh hakën e qisharit e të psallësit, bujqësinë tënde e ke, ç'do më ti?

— Si po e shikojmë, kooperativa ka bereqet, megjithëse është ende e re...

— Mor i uruar, — foli urata duke tundur tespijet — mos shiko ç'kanë në ugar, por ç'futim në hambar.

— Ashtu, ashtu.

Si shumë do ta kishin zgjatur fjalën atë buzëmbremje, por ja që qëlloi darkë e premtë dhe urata, pasi shikoi orën, i tha qisharit:

— Tashti Themë bën mirë t'i biesh këmbanës fort, sa të marrë vesh gjithë enorija që nesër gdhin e kremtja e shën - Sotirit, ditë me nishan, se ai ka lejuar në këtë ditë të burbuletet i krishteri me peshk në këto kreshme të rënda të shën - Mërisë së gushtit.

* * *

Kishte dhe çfarë peme nuk kishte në baçen e manastirit! Themiu atë ditë, kur e takoi për herë të parë instruktori i partisë, na paske marrë një kallam të gjatë, i kishte bërë një bigë në majë dhe s'dinte ç'të hante më përpara.

Fiqtë vijuk ishin plasaritur dhe, sa herë Themiu i çukiste me kallam nga poshtë, ata nxirrnin gjuhën e kuqe dhe s'e futnin brenda për inat të tij. Më lart akoma, në degët e vidhit, rrushi lurushk ia bënte me sy e dukej sikur i thosh: më ha dot mua?

— O Themë — i thirrën që pas blacës e cila ishte mbushur me manaferra.

— Kush është? — tha dhe doli te kapërcyelli; vuri dorën mbi ballë për të parë më mirë, ngjeshi

takijen në kokë e pasi e kuptoi që kishin punë me të, i ftoi të futeshin në baçe. U ulën mbi barin e zverdhur te hija e një pjergulle; filluan kuvendin. Në shenjë miqësie qishari nxori trakaçin e duhanit e jua dha ta dridhnin nga ndonjë cigar.

Instruktori, sekretari i partisë së fshatit dhe Themiu biseduan një copë herë të mirë. Kur erdhi fjala në shteg, gjetën rast dhe e pyetën Themium:

— Si mendoni për kooperativën tuaj?

— Kooperativa është xhenet, sidomos kur ke dhe krah pune.

— Në është kështu pse druhe dhe nuk fute?

— Unë jam për të qarë me gunë në krye. Gjithë sa m'i dinë vuajtjet, më japin hak.

— Sidoqoftë është ca e zorshme të ndahesh nga shokët: në tërë fshatin vetëm ti ke ngelur i veçuar, toka jote duket si veza në mes të kulaçit.

— More shokë, mua më ka zënë këpusha në vend të lig, më kanë varur gjithë këtë këmborë në qafë: qishar, psallës, bujk në tokën time dhe në atë të manastirit. Më dysh nuk ndahem. Po e zëmë se u futa: do të vijnë gjindja të më kërkojnë tok me uratën për punë të shenjta, do të largohem dhe, po u shkëputa, humbas kafshatën. Për tokën i kam thënë kryesisë: «po u hyri në punë, ta marrin».

— Ne kemi nevojë për ty si njeri, pa tokë kemi plot — i tha sekretari i partisë.

— Po ç'më ze krah, o derëbardhë, mua, gruan, apo çupën, e kam me një këmbë në yzengji; ma kanë kërkuar për mblesë. Pas dy vjetësh, kur të më kthehet djali nga ushtria kemi të bëjmë.

Qe e pamundur të bindej. Do të dijë mali se

del hëna, aqë dhe Themiu nga fjalët e tyre. U përshëndoshën me të dhe u ndanë.

* * *

Në një mbrëmje maji Themiu po kalonte përmes varreve me një krah bari të njomë për te hauri i uratës. Pa pritur, lëshoi barrën me bar e u ul mbi të. I çuditur vërente te hajati i kishës diçka. «Mos është hija e të vdekurve të ngritur nga varri kjo që po shikoj» tha duke fërkuar sytë. Ata dy njerëz prapë po përqafoheshin. «Është e vërtetë apo të jetë ndonjë hile djalli?» foli me vete gjithë habi Themiu. Kur e kuptoi se atje patjetër diçka ishte, ai thoshte: «Ja vepra e djallit, që po më shfaqet syve, ... shiko ... shiko si flet, do që t'i vete pas dhe të më mbysë më ndonjë pus ose përrua...» Kur qisharit i erdhën në vesh fjalët e përzemërta: «Si s'm'u hoqe sonte» dhe përgjigjen prej jarani: «I moçmi jashik ka thënë që në prill e në maj gruas mos iu ndaj», bërtiti me zemërim:

— «Mallëkuar qofshin gjithë djajtë e kësaj bote!»

Dy njerëzit u ndanë në drejtime të kundërta, kurse qishari fërkonte fytyrën dhe s'u zinte besë syve.

— Si ka mundësi të jetë e vërtetë? — llafosej me vete Themiu — Si ka mundësi të jetë e vërtetë?! Të bëjë dashuri papu me gruan e ipitropit të vdekur këtu në shtëpinë e zotit... Me siguri kjo është punë e laçove, se ata bij të djallit me bisht dalin mbrëmjeve në formë hijesh të mallëkuara, për të vënë në grindje njerëzit, për të na rënduar shpirtin me mëkate.»

Si i hodhi pelës barin e njomë, Themiu vajti në shtëpi të mblidhej me fëmijët. Sa më tepër mundohej t'i hiqte nga mendja hijet e dreqit, aqë më tepër shfaqeshin. «Mallëkuar qoftë çdo djall, që mundohet të më ndaj nga papu Zariku» — trujti Themiu e ra të flinte.

Më vonë puna mori erë. Kur njerëzia po pëshpërisnin gjithnjë e më shumë se uratën na e paskish zënë sevdaja me të shoqen e epitropit, qishari nisi të dyshonte.

Një herë në kohën e të lashtave, kur po ktheheshin nga lëmi, papu Zariku i tha Themiu.

— Sikur të ka lënë fuqia, o Themiu, u plake më duket.

— Hallet dhe puna e plakin njerinë, o uratë, pastaj dhe i vogël s'jam, vajta pesëdhjetë e pesë vjeç.

— Mirë, o i bekuar, po toka e kishës duhet punuar. Se toka dhe gruaja, që thua ti, o i bekuar, janë një lloj, po s'i lërove, s'të pjellin gjë — u përpoq të bënte shaka prifti.

— Me moshë është çdo gjë uratë — tha qishari, i cili sikur e parandjeu se ku rrihte të dilte papu me ato fjalë.

— Ty t'u çuan fëmija tani — tha urata — mund dhe ta nxjerrësh bukën dhe në kooperativë, po të futesh.

« — Hë, ëëë... — u përcuall Themiu — siç duket kaqë e pat nevojën për mua.»

— Më ngjan se do të kesh gjetur ndonjë më të mirë se unë, uratë.

— Vërtetë që më është lutur një hallemadh — u dëgjua urata — po do të bisedoj me ty një

herë. Të të sqaroj, të mos ma marrësh për keq e të më zemërohesh.

— Po kush na qenka ky? — pyeti Themiu.

— I vëllai i së shoqes së ipitropit. Ti e di që ajo është e ve tani. Nga ana tjetër, vetë i vëllai i saj, Ndonua, është rrethuar nga arat e kooperativës së Rredhit e nuk ka si të dalë fare për në rrugën kryesore.

— E pastaj, ç'më duhet mua se si na qenka Ndonua?

— Je i krishterë, o i bekuar, s'duhet folur ashtu. Njeriu duhet ndihmuar në kohë të vështirë, pa kur është në të mirë të tija e ndihmon vetë perëndia.

— Kaqë e pate nevojën për mua, uratë. Po pse thonë: «Të dihet e mira e kaut nuk shitet në pazar te kasapi.»

— Më dëgjo, o i bekuar i perëndisë, — mori fjalën përsëri papu — ai më lutet që të vijë këtu si bujk i kishës së shën-Thanasit me qëllim që të jetë pranë së motrës. A nuk e mban mend si na e la amanet gruan ipitropi kur vdiq?

Themiu mbushi bulçitë dhe për herë të parë e pa me përçmim uratën; për herë të parë u bind se ato që fliteshin nëpër fshat ishin të vërteta. I nevrikosur tha:

— Sillja, sillja të vëllanë të shoqes së ipitropit, se duhet t'i mbajë kandilin.

— Mos fol kështu, o i bekuar i perëndisë, se po rëndon shpirtin me mëkate të rënda.

Papu Zariku kishte dhe më për të thënë, po Themiu mori të ikte.

— Ndal, o i bekuar, pse më ikën i zemëruar, a po do të lëshoj ndonjë fjalë të mallëkuar.

— Lipsur qofshin bekimet e tua. S'dua të të dëgjoj më, sa po dashke të më dëbosh. Nuk e mendoja të ma punoje kështu.

— Mos i harro kaqë shpejt të mirat që ke patur si bujk i kishës së shën-Thanasit. A po hëngre bukën dhe përmyse kupën. Pse mëshon e rëndohe.

— Mëshoj me ty, që më ke ngrënë me gjithë gunë pa u kuptuar. Më ke gënjyer, më ke hequr pas hijes sate. Më ke ndarë nga shokët.

— Për te shokët, për në kooperativë të hapur e ke rrugën, o i bekuar, nuk të pengon njeri — foli urata duke qeshur e pastaj shtoi me djallëzi — po mos e pëson si ai që pagoi një grosh për të hyrë në valle dhe jepte pesë e s'dilte dot.

— Nuk dua të dëgjoj më nga pallavrat e tua. Mban mend si më the ca vjet më parë: «Mos shiko se ç'kan në ugar, po ç'futin në hambar». Po s'paska qenë ashtu. Kot nuk u bënë gjithë shokët me shtëpi të reja e unë mbeta me kasolle.

Prifti ngeli duke numëruar trespjet, kurse Themiu shkoi nga ara me misër. U ul te hija e një mēni dhe nisi të rilexonte letrën, që i dërgonte i biri nga ushtria. Ndërmjet shumë fjalësh ai i thoshte: «Baba! Mjaft qëndruam të veçuar. Fjala «individ» është një lloj si fjala «privat». S'e merr me mend se sa turp më vjen, kur më pyesin se si i ke prindërit, bujq kooperativistë, apo individ. Është për të ardhur keq që ti do ta kuptosh i fundit dobinë e kooperativës».

Atë mos kur u prish me priftin, Themiu nuk u tremb fare që u nda me të. Arën me grurë e kishte shumë të mbarë. Djali do t'i kthehej nga ushtria. Nga vjeshta, po ta shikonin të udhës, mund të futeshin në kooperativë. Deri atëherë kishte kohë të mendohej për vitin e ardhshëm. Në muajin maj, ashtu pa prituri, kur gruri s'ishte bërë akoma dhe pemët e para nuk ishin pjekur, ndjeu shqetësime në stomak. Mjeku i lokalitetit e nisi shpejt për në spital. Kirurgët e panë me kujdes. Në fillim dyshohej për ngatërrim zorrësh. Si i bënë dhe radiografinë, e gjetën që kish ulçera. Themiu, që s'qe mësuar me spitale dhe me gjilpëra, mezi duronte. Kur i prunë aparatit e serumit, ai u trondit dhe ktheu kokën mënjanë, për të mos parë si do t'i ngulnin getën në damar. Meqë kish dhe anemi, i bën transfuzion gjaku të grupit «A». Dalëngadalë dhimbjet iu lehtësuan dhe e mori veten mirë.

— Si je me shëndet? — e pyesnin miqësia.

— Jam më mirë. Të rrojë partia që ka hapur spitale dhe na shëron falas, — përgjigjej gjithnjë Themiu.

Si u përmirësua dhe më, dilte në dritare e shikonte gjelbërimin e lulishtes së spitalit. Ishte fillimi i qershorit. Gruri duhej korrur. Qershitë duheshin vjelë dhe shitur. Qershitë e tij piqeshin shpejt, andaj shiteshin shtrenjtë. Mendja iu bë verige për të dalë. «Si të lë unë grurin të më humbas dhe qershitë të më prishen» thoshte me vete. Ca nga dashuria për pasurinë dhe ca ngaqë i erdhi fuqia, vendosi të dilte nga spitali.

— Shoku doktor — i tha përgjegjësit të pavio-

nit — dua të më japësh dy javë lejë të dal nga spitali.

Kirurgu shtrëngoi dhëmbët, rrudhi vetullat dhe foli me habi: «Me gjithë mend kërkon të dalësh! Ne mezi të prumë në rregull për operacion, në asnjë mënyrë s'të lëmë.

— Po më prishet malli, shoku doktor!

— Më mirë malli se koka — i tha mjeku.

Nguli këmbë Themiu: «Do të dal dhe s'ka tjetër», hodhi firmën në kartelë dhe iku pa u përshëndetur.

Me të ardhur në rrugë gjeti maqinën «zuk» të qumështit, që e çoi drejt e në fshat. Ngado që hidhte sytë shikonte njerëz që korrnin, lidhnin duaj, shinin grurë. Kur mbërriti te kopshti i tij, s'po u besonte syve. Gruri që korrur, që mbledhur dhe ara kishte mbetur hamullore. «Si është e mundur — thoshte me vete — me siguri që ma kanë marrë tokenë ata të kooperativës, se u është dashur për misër hamullor, kurse për grurin tim as do të kenë çarë kokën fare, po do ta kenë mbledhur aty - këtu siç korret kur bëhet puna angari».

Sa shkeli në oborr, gagaritën patat. Vajza, e cila po milte lopën, bërtiti:

— Nënë! erdhi babai!

Të dyja, nënë e bijë, i dualën përpara, e për-qafuan.


— Si je tani baba?

— Më mirë — ju përgjegj ai — po jo i shëruar.

— Si të nxuarën more burrë pa të shëruar!

— S'më nxuarën, po dola vetë.

— Qysh dola vetë! Po pse?



— Kisha hallin e grurit.

— Kot je merakosur për grurin. Rroftë rinia e fshatit. Erdhën të gjithë dje. Na e korrën, na e lidhën dhe na e shinë.

— Po tokën nuk u a kanë marrë?

— Jo more burrë; as tokën na kanë prekur, as hak kërkuan.

— E korrën me punë vullnetare baba! U korr me kujdes ara, pas lidhjes së duajve mblodhën kallëzit.

— Domethënë, se shokët e fshatit, s'na paskan kthyer kurrizin, na ndihmojnë, na dashkan, kurse unë mendoja se do të kenë marrë tokën.

Themiu u fut në shtëpi, hapi hambaret dhe u gëzua që i pa plotë me grurë.

— Bijë — i tha vajzës — mbushi shportat me qershë dhe shpjerua shokëve në lëmë.

— Grua — i tha së shoqes — qershitë shiti në dyqanin e kooperativës, mos i ço në pazar më. Është turp të sillemi si matrapazë.

— Atje i kam shitur, o burrë — u përgjegj ajo.

— Dhe një porosi tjetër po ju lë: Do të shkoj të shtrohem prapë në spital. Do t'u lutem mjekëve të më pranojnë përsëri. Siç e dini kam për të bërë operacion në stomak. Njerëz jemi. Mundet dhe mos ta hedh dot hendekun, mund të më zërë gjumi i madh, po ju mos u trembni. Bashkohuni me të gjithë shokët. Hyni në kooperativë.

LLAZ PENDARI

Ditë e natë pas qeve e gjen Llazin. Ai gdhihet në qerre e ngriset në qerre. Llazi dhe qerrja janë bërë një. Edhe kur vjen në shtëpi e ha bukë në tavolinë, mendja te qetë dhe te qerrja i fluturon.

— Rri të flesh në krevat, ore burrë, kot s'na e blenë djemtë — i thotë e shoqja.

— E bleva vetë unë moj, pse nuk po derdh djer-së dhe unë? — i përgjigjet ai me shaka.

— Të qe për ty s'qe ndërruar rrogozi me krevat. Po më rrofshin djemtë që më marrin vesh nga bota!

Si për të mos harruar shtëpinë fle dhe xha Llazi rrallë-herë në krevat. Po sa të dëgjojë gjelat e mëngjezit, ngrihet e shkon në stalla.

— Rri ore dhe ca — i thotë plaka — oj, sikur s'është dysheku me pambuk, por me therecka.

— Ashtu thua ti... po se duhen kashaisur qetë, se duhen grazhduar, për këto nuk të vete mendja — i thotë Llazi duke pirë kafe. — Mban mend kur ishim të varfër si kujdeseshim për qetë e subashit që i merrnim me hak... e jo të mos shikojmë qetë tanë në kooperativë.

— Ti, ore burrë, flet sikur atje nuk paska stallierë fare.

— Ka stallierë; po janë të rinj. Duhet mësuar dhe udhëzuar.

— Pika ty — shtoi plaka — kujton se ti e mban stallën. Kur të vdesësh ti kush e di se ç'do të bëhet! Do të prishet kooperativa.

— Mos vdekshim pa u lënë zanatin djemve — tha ai.

— Hoooo, hoo — qeshi plaka — zor i madh të ngasësh qetë me qerre e të lërosh ugar.

— Për të ngarë qetë s'është zor, por për ta mësuar e për ta bërë demin ka, nuk është gjë e lehtë.

Dhe vërtetë është mjeshtëri që do durim dhe kujdes puna e pendarit, që stërvit demat për t'i bërë qe. Ka dema të urtë, që vihen në vijë dhe në brazdë menjëherë, po ka edhe nga ata që vërtiten si të harbuar. Nga të gjithë pendarët e kooperativës «Adriatiku» vetëm Llazi ja dilte mbanë kësaj pune pa u nxehur. Sado të egër të ishin demat, ai do t'i bënte vaj të butë. Llazi ishte aqë i zoti për këtë lloj pune, sa mësonte jo vetëm një dem me një ka, por edhe dy dema bashkë në një zgjedhë. Meqë ai mësonte gjithnjë pendët e reja të gjithë e thërrisnin Llaz Pendari. Është kënaqësi kur shikon Llazin tek mëson demat: në fillim i përkëdhel nga kurrizi, u thotë fjalë të ngrohta sikur të jenë njerëz, i kreh me kashai, u vë zgjedhën bosh, më vonë i mbren në qerre dhe pastaj në pramendë. «Duhet një vit punë pa të bëhet demi ka» — thotë ai. Në vitin e parë do mësuar kau të mbajë vijën në ugar e të mos dalë nga brazda; të mësohet të marrë kthesën në urat e kanaleve. Ja, për të gjitha këto fshehtësi të mjeshtërisë së pendarit vijnë e pyesin

Llazin të rinjtë pendarë, sa herë që s'dinë si t'ja bëjnë me demat e tyre, që nuk shtrohen në kularin e zgjedhës. Kur niset karvani i qerreve për të marrë dru, për të mbartur drithë, ose pambuk, qerrja e Llazit vihet në krye.

* * *

Një ditë vere fare pa pritur Llaz Pendari u gdhi i sëmurë dhe e shtruan urgjent në spital. Atë ditë qerrexhinjtë e nisën rrugën pa Llazin.

U vinte keq për ustanë e tyre pendar, që i ra sëmundja fare pa pritur. Llaz Pendari po u afrohej të gjashtëdhjetave, po s'qe ankuar nga shëndeti. Vinte i thatë e i hequr si dru shqope, po i fortë. Puna i jepte gëzim e këngë. Llazi s'qe mësuar të rrinte shtrirë dhe jeta e spitalit, i dukej e rreptë. Me sustë qe krevati dhe dysheku ishte mbushur me lesh, po ku gjente qetësi Llazi në «kafaz», siç i thoshte ai spitalit. Llazi kishte marrë një ftomë ca ditë përpara, andaj i mbahej ca fryma dhe e ngacmonte kolla, që i kujtonte një pleurit të vjetër. Si bëri ca gjilpëra e piu barërat, zjarri i iku e kolla e la. Po ku dëgjonin mjekët për ta nxjerrë! Erdh e t'u mërzit Llazi si asnjëherë.

Sa kohë qe në spital ditë pa shokë nga fshati nuk pati. Sa më shumë shokë t'i vinin, aqë më shumë përmallohej Llazi. Të gjithë i pyeste e të gjithëve u linte nga një porosi. Llaz Pendari qe mësuar të flinte pak e të bënte udhë me qerre shumë, kështu që në spital e kishte të vështirë ta zinte gjumi menjëherë. Tërë natën mendja i bëhej verige e i merrte fluturim nga arat e kooperativës, nga shkarpa e kaminës, nga stallat e qeve e deri te

qerrja. Kur i kujtoheshin qetë e rinj, të cilët s'ja kishte lënë dorëzim ndonjë pendari të mirë, i pikonte në zemër. Bëhej merak Llazi për ta, se ishin më shumë dema se qe: «S'regjet demi me tre muaj punë e të bëhet ka» — u thoshte njerëzve, kur i porosiste.

— More po ti sa le porosi për qetë nuk po le për njerëzit — i tha njëri nga shokët e dhomës.

— Njeriu është njeri — iu përgjegj ai me shaka: — Njeriu ka gojë e flet, po qetë janë kafshë e kafsha s'di të tregojë.

— Shëndoshë e mirë i ke — i tha brigadieri.

— Kujdes mos e lini atë Murgjinin pa ujë.

— Çdo ditë e çojmë nga dy herë te pusi i mirë — u dëgjua një djalë stallier, i cili kishte ardhur me brigadierin për të vizituar Llazin.

— More çun — iu drejtua xha Llazi — unë e di që ju i çoni në luk për të pirë, po Murgjini do me kovë. Nuk e kanë mësuar në vogëli të pinte në koritë. Fajin ma kanë rritëset e viçave e jo ai.

Njerëzit po vinin buzën në gaz.

— Druaj se do ta keni djegur për ujë... se është dem i çuditshëm Murgjini, kokëfort i madh. Dem për vete e ka, po ja që s'më rrihet mua.

— Mos u bëj merak as për Murgjinin, as për Balashin; janë shëndoshur dhe urtësuar njëlloj si të ishe ti — i tha brigadieri. Mos e mbaj mendjen as nga shtëpia, as nga kooperativa, çdo punë na shkon në rregull, po shiko shëndetin; dëgjo ç'të thonë doktorët.

— Ç'pyet për doktorët — foli duke luajtur kokën Llazi — ata e masin kohën me javë, jo me ditë. Unë jam mirë tani, ata thonë të më mbajnë dhe ca javë.

— Do të kthejnë shëndoshë e mirë, që t'i hipësh qerres si djalë, pa i ndaluar qetë — i tha pendari i ri. — Ashtu si gjithnjë.

Llaz Pendari qeshi nga kjo lëvdatë e tha:

— O po iku vapa me gusht; u muar vesh, s'jam ai që ishja para dhjetë vjetëve, po edhe kështu si thonë këta doktorët nuk durohet. Pse ore, qëndrohet në kafaz? Edhe zogu që është shpend s'e duron dot, jo njeriu. Vajti kaqë kohë e doktorët shty java-javën.

* * *

Një ditë tjetër xha Llazit i erdhi sekretari i partisë së kooperativës me dy pendarë. Ata i treguan për mbarësinë e drithërave dhe të pambukut. Llazi, i gëzuar për prodhimet e mira, pyeti:

— Po lulët e diellit si duken?

— Det — foli sekretari — s'çahen fare, me sopatë kemi për t'i korrur, jo me drapër.

— Dhe këtë vit do ta tejkalojmë planin me siguri — tha stallieri i ri — sa një tepsi i kanë bërë kurorat e luleve e plot me bukaz.

Kur shokët nga fshati muarën të largoheshin, xha Llazi i tha pendarit të ri:

— Ti, o Mitro, që po punon me qetë e rinj, hap sytë me Murgjinin. Zbrit nga qerrja në kthesa. S'di të marrë kthesë Murgjini. Mendjen duhet ta kesh sidomos te urat e kanaleve, se i uruari kthen para kohe dhe ta rrëzon qerren në kanal.

* * *

Pas ca ditësh Llaz Pendarit i erdhi oreksi për bukuri e ai u shëndosh si asnjëherë. Një mëngjez, pas buke, Llazi, nga dritarja e pavionit po shikonte

pamjen e zonës industriale të qytetit. Oxhaqet e T.E.C-it e të Rrafinerisë gërvishnin qiellin; kullat e ftohjes vinin në kokë shami të bardha resh. Dhjetëra kolona të Azotikut ngriheshin lart e më lart, duke përqafuar njëra - tjetrën.

Llazi, i cili s'kishte ç'të bënte, çdo ditë si për t'u zbavitur numëronte kullat e kolonat e Azotikut; që andej, nga kati i tretë i spitalit, zona industriale dukej si në pëllëmbë të dorës.

Sado që Llazi mundahej të mos lajthiste, kur numëronte, prapë i ngatërroheshin kullat e oxhaqet. Kështu, duke numëruar kolonat e larta e gjeti atë mëngjez shefi i pavionit, doktor Leka.

— Hë, ëë xha Llazi, si i ke punët?

— Unë mirë them, po ç'më thoni ju.

— Do të dalësh sot.

— Të falem nderit e të lumtë goja, doktor.

* * *

Tek ecte me nxitim për në shtëpi, Llazi mendonte me vete se si erdhi i pafuqishëm dhe si po ikën plot shëndet. Iu kujtua koha e shkuar, kur iu sëmur djali, vajti në qytet për ta vizituar, pagoi sa s'thuhet dhe s'i gjeti të gjitha barërat. Djali iu dergj në lëngim dhe i vdiq. Kurse sot vete tjetri në spital e del që andej pa paguar asnjë qindarkë.

Mbrëmjen e parë dhe të dytë xha Llazi pati në shtëpi shumë njerëz, që vinin për ta uruar, se u kthye shëndosh e mirë.

Ditën e tretë ai doli nga arat e nga stalla. Çmallej me fushat njëlloj si me njerëzit.

— More po s'më kanë zënë sytë Murgjinin me Balashin — i tha një stallieri.

- Ti s'ke më punë me qetë — i tha ai.
- Pse? — pyeti me habi xha Llazi.
- Po kryesia vendosi të të japë një punë të lehtë, meqë ke qënë i sëmurë kaqë javë.
- Si si!! Po ku më paskan çuar?
- Roje në domate.
- Nga ajo punë mua më vete buka frrapa kurrizit, s'është punë për të qenë ajo.
- Për të mirën tënde kanë menduar, ore xha Llazi, mendo se dhe mosha kërkon të sajat; plak farc s'je, po dhe...

— More e di unë që poshtë po bëj, s'po bëj lart, po dhe aqë sa për të më hedhur jashtë radhës së pendarëve nuk jam.

Me bastunin në dorë dhe me zemëratë në zemër xha Llazi vajti drejt e te përgjegjësi i sektorit, po s'e gjeti. I thanë se kishte shkuar për të bërë punë fizike në pyllin e Mersinës. Atje po prisnin dru shqo-pe si shkarpë, për të djegur tullat dhe tjegullat e kooperativës.

Llaz Pendari la bastunin e mori sopatën; pastaj u nis andej nga pritej shkarpa. Ai ecte mbi trragat e qerreve, duke shkelur mbi gjurmët e kujtimeve të mëparshme.

Sapo e panë ata që prisnin dru, thanë:

- «Ja, po vjen Llazi.
- Si duket s'do ta ketë pritur mirë punën e re — tha kryetari.
- Me siguri i ka ardhur keq që e hoqëm nga puna e pendarit — tha përgjegjësi i sektorit të parë.
- Sa të paska marrë malli, o Llazi, erdhe deri këtej që të na takoje.

— Mua më merr malli, po ju s'pyesni për mua e s'doni ta dini fare.

— Si ta nxe goja këtë fjalë — i tha kryetari i kooperativës, duke e përçafuar.

— Ja, më ndërruat zanat, se kujtuat që mora tjetër udhë. . .

— Dëgjo o xha Llazi, nuk është ashtu. . . Ne menduam të të lëmë të qetë si për moshën si për sëmundjen — i tha kryetari, duke fshirë djersën.

— Sëmundja ma mori të keqen, po dhe në po zbardhem nga koka, o shoku kryetar, zemrën e kam të re — i tha xha Llazi me zë të qeshur.

— Domethënë ti, xha Llazi, nuk ndahesh nga qetë.


— As nga qetë, as nga qerrja nuk dua të ndahem. Më pëlqen që atje të më vijë dhe fundi, mbi qerre.

— Le të bëhet e jotja — tha kryetari.

Pastaj xha Llazi, kryetari dhe pendari i ri shkuan te Murgjini dhe te Balashi, te qetë e dashur të xha Llazit. Qetë e rinj, me ta parë, ngritën kokën e përçapeshin sikur donin t'i thoshin: «Ku ke qenë?» Llaz Pendari pa e zgjatur, futi dorën në trastë, nxori dy copa të njoma lëpushkash dhe ua dha, për t'i afruar më shumë.

Pasdreke, si ngarkuan qerret e lanë qetë të kulloshin nga një bark bar, pendarët u ulën në hijen e një verrii, rreth zjarrit, për të pjekur nga një misër të njomë. Aroma e të pjekurave që dilte nga zjarri përzihej me erën e detit e të jepte uri.

Shakatë dhe këngët shkriheshin në uturimën e



detit aty pranë, që nga vinte ai fllad që përkëdhelte
kurrizin e pishave dhe fytyrat e njerëzve.

Aty midis shokëve Llaz Pendari e ndjente veten
të lumtur, të përtërirë, të shkrirë përjetësisht me
tokën dhe me qerren.

TAQI DREDHAQI

N é katin e parë të Komitetit ekzekutiv të qytetit Ç., pas lulishtes së vogël, duket dritarja e sek-sionit të arësimit. Po t'ju ketë rënë rasti të rrini në hijen e akacjes së kësaj lulishteje, do ta kini parë me siguri atë burrin ballëmadh me gjyslykë, që gjithmonë rri i kërrusur mbi shkresa (sa qejf i ka ato!). Kur mërzhitet, del në dritare, shikon lulet e shumëngjyrëshme në mes të të cilave tundet një kallam lozonjar.

Personi që po ju tregoj është Taqi Dredhaqi, ose si e quajnë disa Z. Taqi, inspektori i shkollave të qytetit. Puna që tërhiqte më shumë z. Taqin ishte: kontrolli i planeve, i statistikave, i ditareve.

I mblidhte shkresurinat mbi tavolinën e drejtorit të shkollës, ulej në karrige e zhytej në to.

S'para e hante meraku të futej nëpër klasa. E pse të lodhej aq fort, të bënte aktkontrollet, të dëgjonte lloj-lloj nxënësish, të humbiste durimin e të bëhej nervoz.

— Sa për gjendjen e cilësisë dhe të sasisë, unë mbështetem kryesisht në planet tuaja — thosh inspektori. — Ato janë pasqyra e punës suaj.

Apo s'ishte i zoti për të gjetur materiale për mbledhjen e këshillit pedagogjik!

Këto punë i dinte, si i thonë, ujthi, e kishte për kollaj të shkruarët. Si pedagog i vjetër dinte ta «trajtonte» kuadrin; as të kritikonte, as të lëvdonte; e kjo jo pa arsye. Bile ishte vërtetuar më se një herë se z. Taqi pat thënë hapur:

— S'është mirë t'u rrisim veshët njerëzve, por as edhe t'i dekurajojmë me kritikën tonë, ajo duhet të jetë e mprehtë, parimore, një kritikë që të ndihmon për të ecur përpara.

Pa kur zinte e fliste Taqi për gjendjen e shkollës, të kishe veshë e ta dëgjoje, se ai kurrë s'kishte të mbaruar. Thonë se pak kohë më parë Taqi ishte i dhënë aq shumë mbas mbledhjeve me mësonjësit dhe i zgjaste kaq tepër këto të shkreta, sa që disa merrnin brisqe me vete për të qethur mjekrën.

Vërtet i zgjaste ai ligjëratat, por i trajtonte me respekt njerëzit, kritikën e tij ngjanin si përkëdhelje. E si mund të bënte ndryshe inspektori?! Po të godiste njërin, do të qortonte dhe tjetrin dhe po të vepronte kështu, s'që e kollajshme për të; ai gjatë kohës së detyrës së inspektorit kishte arritur të rregullonte e të mbante në zonën e vet gruan, kunatën, kushërinj; me një fjalë gjithë tarafin që merrej me mësuesi.

«Taqi lë kokën për ne — thoshin njerëzit e farefisit — prandaj dhe ne s'duhet të lëmë kusur për të». Kurse Taqi, sa herë ndodhej në rreth familjarë, përsëriste: «Po më mbajtët do t'ju mbaj». Taqi ishte i regjur në detyrë. Gjërat i bënte të matura dhe kur ndihmonte ndonjë nga fisi, i rregullonte punët në atë mënyrë që mishi të piqej e helli mos të digjej.

Kishte shumë vjete Taqi Dredhaqi si inspektor, por kurrë nuk i qe skuqur faqja, jo se ai ishte fare pa njolla, po se dinte t'i fshihte hilet.

* * *

Një ditë mes jave inspektor Taqi i tha shefit të seksionit, se do të shkonte nga shtëpia e pionierit për t'u interesuar për programin artistik që do të jepej me rastin e festës së Vitit të Ri.

— Shko — i tha shefi — dhe mbi të gjitha duhen bërë përpjekje për baletin. Deri më sot vetëm një valle kanë arritur të realizojnë bukur.

— Si urdhëron — shoku shef — keni të drejtë, duhet vënë rregull.

— Rregull, rregull, por rregulli vihet me punë dhe jo me fjalë. Për dobësitë e shtëpisë së pionierit përgjegjësini më të madhe e mbajmë ne si seksion dhe në radhë të parë ti, shoku Taqi, si inspektor zone dhe Zeneli si inspektor për punët e kulturës.

Taqi Dredhaqi nuk e zgjati më me shefin e ri. Ai e kishte kuptuar se shefi kishte një shpërfillje për të. Një herë, kur Taqi po fliste me letër në mbledhjen e seksionit për stilin e ri të punës, shefi e ndërpreu dhe me një ton të prerë i tha:

— «Kur diskujtojmë për revolucionarizimin e metodave, duhet të mbështetemi në fakte konkrete. S'kanë vend frazeologjitë pa shembuj.»

Taqi ishte i zoti për t'i njohur në thellësi eprrët dhe për t'u ardhur atyre sipas dëshirave. Po me gjithë këto prirje Taqi Dredhaqit i ngeci sharra në gozhdë me shefin e ri. Ai ishte i prerë, punëtor i palodhur, studjonte me etje në shumë drejtime, ko-

hën më të madhe e kalonte nepër shkollat e fshatit. Një herë në një mbledhje të seksionit Taqi Dredhaqi po i bënte lëvdata shefit, po ai përdrodhi buzën e ja preu:

— Futu më mirë në temë, o shoku Taqi.

Me një fjalë inspektori ynë e njihte mirë shefin e ri, prandaj tregohej si i papërtuar. Po ç'e do. Me gjithë dëshirën e tij për të qenë i përpiktë, atë ditë e gënjeu shefin që në mëngjez. I tha se do të vinte në shtëpinë e pionierit, kurse inspektor Taqi, në të vërtetë, donte të gjente shkak për t'u larguar nga zyra e të vinte në MA - PO - n industriale, ku do të dilnin këmisha najloni për shitje.

Me hap të rëndë Taqi doli nga zyra. Në kokën e tij po përziheshin dy mendime. Njëri e çonte drejt MA - PO - s e tjetri drejt shtëpisë së pionierit. Kur vajti para MA - PO - s, inspektori tha me vete: « — Hë tutje, se shtëpia e pionierit pret dhe më vonë. Pa të marr një këmishë najloni të bardhë. . . pa punët e shtetit e ujët e detit nuk mbarohen kurrë. Fundja lejë i mora shefit. Në shtëpinë e pionierit vete dhe ca më vonë. Mjafton hija jonë të duket atje, pa njerëzit vihen në lëvizje vetë.» Si kaloi një kohë e mirë, Taqi Dredhaqi po i afronte radha. Tek priste të merrte këmishën, mendonte se ç'punë e rehatshme i kishte qëlluar. «Po fundja — fliste me vete — kanë menduar pse më kanë vënë në këtë vend, se m'i njohin aftësitë. Qerrexhiu mjafton të dijë t'i ngasë qetë, pa qerrja ikën vetë; kështu është dhe puna e shkollës, mjafton të nxitësh arësimitarët, pa shkolla përparon vetiu.» Në këto kohë e sipër Taqi Dredhaqi arriti para shitëses. Bleu këmishën najlon, e vuri nën sjetull dhe mori të dilte jashtë.

Ai u nis të çonte këmishën në shtëpi dhe që atje të vinte në shtëpinë e pionierit.

Shefi i seksionit priti sa priti Taqin pastaj kërkoi në telefon shtëpinë e pionierit. Kur drejtori i shtëpisë së pionierit i tha se nuk qe parë fare inspektor Taqi, shefi shtrëngoi dhembët duke tundur kokën. «Qenka dhe gënjeshtar» tha me vete. Shefi e donte me ngut Taqin se do t'i linte disa porosi, meqë ai do të shkonte në gjimnaz bashkë me disa metodistë të Ministrisë, me qëllim që të organizonin sa më mirë sesionin shkencor të studimeve pedagogjike. Pasi ja la udhëzimet përkatëse një inspektoreje, që sapo ishte kthyer nga fshati, shefi tok me shokët e Ministrisë doli nga zyra. Duke ecur në rrugën kryesore, i vajtën sytë te Taqi Dredhaqi, i cili po zbriste shkallët e MA - PO - s me këmishën nën sqetull. Taqi, i cili për bela akoma s'e kishte parë shefin, bisedonte përzemërsisht me një kalimtar tjetër.

— E po ta mbash me shëndet — i tha qytetari.

— Falemnderit — iu përgjegg inspektori.

— Zoti Taqi! E mbajtshi me shëndet. Po sa e bukur! Doja dhe unë një për burrin, po s'mundem, jam në orarin zyrtar — i tha një nuse e re.

— Moj vajzë dhe unë në orarin zyrtar jam, po më ra rruga këtej, se kisha një punë që ma ngarkoi shefi i seksionit.

— Shefi ta ngarkoi detyrën, po dhe ti shoku Taqi qenke i vetmi për ta zbatuar — i tha shefi, kur u ndodhën fare ballë për ballë.

— Unë, unë... sh sh shoku she shef — fliste i çuditur dhe me gjuhë të belbëzuar Taqi Dredhaqi i gjendur ngushtë — më ra rruga jo se erdha kastile.

Ai deshte të fliste dhe më, por shefi iku përpara dhe as desh ta shikonte me sy.

* * *

— «Ç'qe kjo ditë terse për mua sot» mendonte Taqi kur po futej në zyrë. «Po ç'm'u desh dhe mua këmisha në orarin zyrtar, sikur s'e di çfarë shefi kam». Në stolin e korridorit para zyrës së inspektorëve po priste një mesuese e re. Ajo kishte ardhur me qëllim që të dorëzonte kopjen e diplomës, të cilën ja kishte kërkuar seksioni i arësimit me urgjencë.

Sapo pa inspektorin në korridor, ajo i tha:

— Shoku inspektor! Kam sjell kopjen e diplomës, që më kërkonti.

— Prit pak — i tha Taqi.

Pa pritur erdhi dhe një nuse. Ajo e pyeti mësuesen e re:

— Kā njeri brenda?

— Jo.

— Po pse s'fute?

— Më tha prit.

— Cili është?

— Taqi Dredhaqi.

— Vetëm ai?

— Po.

— Më lejon të futem, kam nevojë të ngutshme.

— Posi, futu — i tha mësuesja e re.

Ajo trokiti.

— Hyrë! — u dëgjua që brenda zëri i inspektorit.

Nga shprehja e jashtme u tregua aqë hijerëndë, sa s'luajti as nga karrigja, po përshëndeti me një tundje të kokës.

— Ç'kemi shoqe? — pyeti me një ton autoritar.
Menjëherë mbas zërit të tij të trashë si qerre e prishur, u dëgjua ajo me zë peligorge.

— Unë z. Taqi kam nevojë, kam shumë nevojë për të vajtur në Tiranë disa ditë.

Taqi me sy të zgurdulluar foli:

— Tashi që jemi në pragun e provimeve kërkon të marrësh lejë, të të bëhen klasët çamur? Puna do ndërgegjeje. Dhe në qoftë se s'keni ndërgegjeje, duhet ta krijoni në punë.

— Nevoja ime është urgjente, zoti Taqi, është një rast i jashtëzakonshëm.

— Ndonjë vdekje? — tha Taqi.

— Jo, martesë, zoti inspektor.

— Ahaa marteesë, qejf. S'ka lejë. He he, martesë! Ne po na digjet mjekra, ti thua dale të ndes cigaren. Jemi para provimeve, i duhet vënë gjoksi punës.

— Ah, inspektor, të më kuptoni se ç'brenjë po më shkaktoni! Për fjalë të nderit kemi shkuar si motër me atë.

— Domethënë s'e paske motër — foli serbes z. Taqi.

— Motër jo, por e kam shumë të afërt — u përgjegj mësuesja — ajo është e bija e mbesës së gjyshes së burrit.

— He he — qeshi me zemërim Taqi. I tekot së bijës së botës për në Tiranë dhe thotë të marrë lejë për dasmë! Dhe kujt do t'ja luash pjesën! Mua, Taqi Dredhaqit, që gjer më sot s'ma ka hedhur asnjë. S'të shkojnë fjalët te unë, prandaj hidhja patës ato. Dhe si thotë pa: «E kam bijën e gjyshes së mbesës së burrit!».

— Jo, inspektor, e bija e mbesës së gjyshes së burrit.

— S'ka rëndësi; fakti është se s'keni arësye. Nuk i ha Taqi ato.

— Sa kemi ardhur në këtë qytet, inspektor. Meqë kemi ardhur rishtazi, s'e kemi tërhequr gjithë plaçkën, kështu që...

— Si të quajnë shoqe — i ndërpreu fjalën zyrtari.

— Elvira. Jam e shoqja e dentistit të ri — tha ajo. Dera e zyrës kishte mbetur e hapur, kështu që mësusja e re, e cila vazhdonte të priste, dëgjonte pa dashje gjithë fjalët e bisedës. Mësuese Elvira u çudit pa masë, kur pa inspektor Taqin, i cili deri pak më parë i kishte qëndruar si kaposh i ngrehosur, iu çua më këmbë, vuri buzët e trasha në gaz, zbuloi dhëmbët ngjyrë kafe e foli duke zgjatur dorën:

— Të njihemi: jam Taqi Dredhaqi, inspektor i shkollave të qytetit. Ju jini kuadër në zonën time. Gëzohem. Punët me kuadro të përgatitura si ju patjetër do të venë mirë. Njihem dhe me burrin tuaj, Bardhylin.

— Ashtu!

— Po po, më ka rregulluar një dhëmb. Është djalë i mrekullueshëm edhe si njeri e si doktor.

— Më bëhet qejfi që flisni mirë, zoti Taqi.

— Të kuptohemi, jo se dua t'ju bëj kompliment, por se kështu është e vërteta. Ngaqë m'u duk shumë i mirë, edhe dhëmbët e tjerë me atë do t'i rregulloj.

— Do t'i them, z. Taqi, që të kujdeset si për mua.

Taqi i turbulluar, i djersitur, shoi cigaren dhe po përpiquej ta dredhonte fjalën e parë.

— E më duket sikur thatë se kishit nevojë për të shkuar në Tiranë.

Hapi dritaren për freski, por vapa s'po i hiqej.

— Si urdhëron, zoti inspektor, bile kam shumë nevojë.

— Po, po, nevojë e rëndësishme. E ke pasur shoqe vogëlie.

— Shoqe vogëlie dhe një farë krushqie siç jua përshekrova.

— Natyrisht për raste të tilla — foli Taqi Dredhaqi, duke kërkuar fjalë — bëhen dhe lëshime. Po vetëm rezervohemi për kuadrot qëë nuk kanë qenë korrekt me detyrën. Sa për ju jam iiii i sigurtë plotësisht se shkoni për një nevojë me rëndësi. Ju, më falni, ju veproni tamam siiii e lyp nderi dhe zakoni në detyrat shoqëroreee.

— Si urdhëroni inspektor, kjo që thoni është e drejtë... Dhe ju falem nderit për pritjen tuaj të ngrohtë. Sjellja juaj e njerëzishme të bije menjëherë në sy.

— Ju lutem, ju lutem — u dëgjua inspektori duke tundur kokën — të fala shumë burrit thuaj Bardhyllit.

Kur iku Elvira, hyri mësuesia e re me kopjen e diplomës në dorë.


— Shumë më vonuat, shoku inspektor.

— E po ja, kishte halle ajo shoqja para teje — foli me zë të rëndë Taqi Dredhaqi.

— Kishte «halle» se ti je si mësalla me dy faqe.

— Jam si jam unë, ka kush e gjykon atë punë. S'je bërë ti të ma tregosh mua, more vesh?

— Unë do t'ja tregoj gjithë qytetit — e i mëshoi zërit mësuesja e re, që solli kopjen e diplomës.



Pas një ore te këndi i fletërrufeve para Komitetit ekzekutiv ishte vendosur një fletërrufe drejtuar:

«Inspektorit të seksionit të arësimit,
Taqi Dredhaqit nga mësuesja Drita Shpëtimi».

Çështja e ngritur në fletërrufe po zjente, po Taqi Dredhaqi e kishte mendjen te shefi, te ndodhia që i rastisi paradreke.

Kur mbaroi orari zyrtar, ai zbriti shkallët dhe meqë pa shumë njerëz para fletërrufeve, u kthye, e u fut në mes të grumbullit. Taqi s'po u besonte syve, tek shikonte emrin e vet. Hoqi gjyslyket, i fshiu dhe prapë po emri i tij i dilte. Inspektor Taqi nuk mundi ta lexonte deri në fund. Iku i hutuar, i turbulluar, tym. Duke ecur i brengosur anës trotuarit, Taqi mendonte: «Paska qenë ters kjo ditë. S'mjaftoi pëllëmba e shefit në mëngjez, ja dhe një grusht tjetër tani». Po Taqi kishte kusure shumë. Prandaj anës fletërrufesë së madhe u shtuan dhe fletushka të tjera për Taqi Dredhaqin. Ditën e parë Taqi u bë i sëmurë, të dytën u ngrit, po dheu i bëhej gropagropa, i dukej se do ta zinte qielli poshtë. Një natë, kur te fletërrufetë nuk kishte fare njerëz, Taqi u ndal dhe i lexoi të gjitha. Në njërën nga ato shkruhej: «Edhe ujët, që qëndron në një vend zë erë, prandaj dhe ti shoku Taqi duhet të lëvizësh, të futësh thellë midis njerëzve. Ti ke shumë nevojë të ajrisesh me frymën e kohës sonë. Vetëm kështu mund ta heqësh mykun që të ka zenë ndërgegjja.»

— Edhe kjo ditë më ters se të tjerat — belbëzoi Taqi me vete, po në çast, nga prapa dëgjoi një zë:

— Ditët janë të mbara, po ters je ti vetë.

Taqi u kthye dhe pa një nga viktimat e veta, që lexonte tërë vëmendje fletërrufetë dhe s'i hodhi asnjë vështrim Taqit.

Ndjeu një shqetësim të paprovuar më parë nga mospërfillja krenare e këtij njeriu të thjeshtë.

Shkau në heshtje. Po endej rrugicave i hutuar, i shastisur derisa vonë u gjet papritur pranë portës së vet. Si mbylli derën, u ndal e i tha vetes me zë të dridhur: Thua më kanë marrë ters, apo jam vetë kaqë ters?

— Përse kaqë vonë, o Taqi? — i foli e shoqja që nga shkallët.

— Më mirë vonë se kurrë — iu përgjegj Taqi sikur fliste me veten.

NË PLAZHIN E POVELÇIT

Rrallë e dendur, mbi gjurmat e dikurshme të rru-
gëve të moçme të lumit të vjetër Seman, ngri-
hen disa fshatra, që janë bashkuar në kooperativën
«Adriatiku». Që andej është dajë Kozmai. Ata, që
s'e kanë parë sot e pesëmbëdhjetë vjet të shkuara,
nuk e njohin dot, jo vetëm pse i janë zbardhur flo-
kët, por Kozma Kotruvja ka ndërruar dhe lëkurë:
s'mbath më opinga lope me rretra, xhidikët i ka bërë
pantallona, mëngoren e ka hequr dhe mëngët e kë-
mishës i ka ngushtuar. Vetëm takijen s'e hoqi dhe
nuk e hoqi. Vërtet dajë Kozmai ka shtatë krahë pu-
ne dhe vetë s'del në kooperativë, por duart i hanë
për punë. Më shumë i vjen ndoresh për bagëti, se
gati tërë motin ai bari e çonte. Si njuh bujku i mirë
ugarin, dajë Kozmai njuh meranë.

Tashti, në moshë të thyer, nuk i ndjek dot lo-
parët e rinj, që u hipin këmbëve dhe fryjnë nga ku-
llota e Polveçës në Verri, a në Laçanj pas tufës së
bagëtive. Shumë i do meritë dajë Kozmai, po më
shumë i pëlqen ajo e Povelçës, ajo kullotë e rrethuar
nga brigjet me rërë, që ngrihen mullar - mullar
gjithë kum dhe që myzeqarët u thërrasin bëse. E në
këto bëse me rërë, ku rritet lurushku lastar - lastar,
ruhen kujtimet e kushedi se sa njerëzve.

Dhe Kozma Kotruvja, këtej e kaloi vogëlinë. Në
këtë mera ai lojti cingël e dokërr, këtej mësoi t'i bin-

te fyellit, bile këtej thonë se ai pati parë Marien e Gor Sheqit, kur ndiqte pulat e detit me kallam fushës dhe më vonë i shtyri lajmës dhe e mori nuse.

Shumë mote kishin shkuar dhe bariu i vjetër s'e kishte shkelur meranë e qetë mbushur me marina dhe vërrinj, nga këndonin lareshat dhe stomeqët. Por një ditë vere ai e mori se e mori këtë rrugë. U nis për të gjetur mëzin e madh, që azdisej me pelat e harbuara. Tek ecte me nxitim e shikonte anës detit, pa njerëz, që së largu i dukeshin të hollë e të gjatë si kallami. Kur kaloi tre bëse, dajë Kozmai u çudit: pa një njeri krejt lakuriq me një pëllëmbë të mbathura dhe rrinte si i ngrirë kallëp pesëmbëdhjetë metro larg valëve.

Dajë Kozmait, që e mori për ndonjë pa frymë, kur pa se ai lëvizi këmbët, i shkriu gjaku. Udhëtari ynë vazhdonte të ecte nëpër rrugën tërë kum. Për çudi të tij, gjeti përsëri njerëz, kësaj radhe dy. Sapo i diktoi se qenë një mashkull e një femër dhe fërkonin njëri - tjetrin me vaj, tundi kokën me zemëratë. Kuajtë që dukeshin tutje nga vërrinjtë, ja hoqën mendjen dhe ai e ngau pelën me nxitim.

«Ç'janë këta të kërcurë, që lënë shtëpinë dhe bëhen dy e dy këtej nga lan bishtin shejtani... Të jetë plazhi ky që lllomotit rinia?»

Në këto e sipër dajë Kozmai u gjend në mes të tufës së kuajve. Kur e gjeti mëzin, e ndolli pas pelës dhe u fut në tragën e qerreve mes jamrukut dhe marinave. «Mirë që lahen, po pse kaq lakuriq? Dhe ne kemi ardhur këtu, po rrinim si njerëz» — mendonte plaku dhe ëndërronte për darkën e shën — Mërisë, kur mbushnin qerret me fëmijë, gra dhe burra e futeshin në det. Gratë futeshin mënjane me

linja të gjata, burrat shkonin ca më larg. Pa e bërë të gjatë shumë ktheheshin për në shtëpi. Kështu e kuptonte detin Kozma Kotruvja, kurse ata trupat, për të cilët i vinte të pështirë, se i dhanë datën e i ngjanin shejtanit pa bisht, nuk dinte si t'i quante.

Me të zënë mëzin dajë Kozmai e një të shitur. Me ato para bleu një lopë. E për këtë lopë ai zgjidhte majë bari. Ku të ish ovradi më i ruajtur, ajo do ta vinte nockën më e para.

Një të dielë, kur shkante drejt shtëpisë, u ndal te një fik me kokrra të pjekura dhe nxirë e bërë plasra - plasra. Daja ngjatsoi lopën, u ngjit lart e hëngri e u dënd sa s'i vajti mendja për të ngrënë mëngjez. Me të ardhur në shtëpi, lidhi lopën dhe lëshoi viçin ta mëzonte. Atëhere pa të vinte në vend të çupës së tij, Gjenës, plakën.

— Ik, moj grua tutje, s'e mjel dot ti këtë, ke hije të rëndë, s'të qas ty ajo, po thirr Gjenën.

— Do ta mjel unë sot, burrë, se vajza na iku në det.

— Çfarë moj?! Iku në det! Ke gojë e flet! S'ke turp kur thua? Cilin pyeti?

— Oj dhe ti... cilin pyeti, ja, iku... me shoqe është... apo jemi në kohën e Ballit dhe të kemi frikë.

Dajë Kozmai nxehej shpejt, si gryka e qumështit, për gjërat që s'i pëlqenin. E shoqja, e cila ia dinte këtë huq, s'i ndihu në fjalë, sapo që ja pa veshët flakë si lafshë këndezi. Plasi dajë Kozmai për të hapur sherr e të shfrente, por sa foli lopa, aqë fjalë bëri plaka.

— S'dua unë të më ngrërë bisht çupa, se i pres mustaqet fët me gërshërë dhe bëhem grua. Dhe ashtu në palcën e vapës, pa e bërë as një as dy, i hipi pelës dhe u nis për në det. Atë ditë kishte që-

lluar e kremte e rëndë, se kishte rënë dy herë kambana e madhe. Duke ecur tërë zëmëratë, dajë Kozmai na takoi me uratën e norijes, papu Nikollën.

— Si venë punët nga kisha? — e pyeti daja sapo e përshëndeti.

— O qysh venë?... Ja, ashtu si nuk do Zoti. Sot, ore i bekuar, që kemi ditën e shën Pandelimonit, dëshmor i madh shërimtar, vetëm me tri veta e meshova kishën.

— Po pse kaq keq?

— Po pse u bënë burrat gra dhe gratë po shijnë si duan ato. Ja, dhe sot një kamion plot me nusëri e çupulina u nis për në plazh.

Kozmai ynë tundi kokën me keqardhje. Papu tha përsëri:

— Kësaj, ore i bekuar, sot ditën e shënjtëruar, i thonë kështu: lëre rrugën e perëndisë, mos ec në kishë dhe nis rrugën e shejtanit, ec në plazh, atje ku njeriu zhvishet e përçmohet si dreqi.

Kështu duke shfryrë si poçja me fasule kur zjen, u nda dajë Kozmai nga papu Nikolla tërë mëri në shpirt dhe mallëkim në zemër për të bijën.

* * *

Shkumë gojën dhe djersë kurrizin e bëri hajvanin daja, aq shumë e ngau. Pasi bëri disa vrape pe-
le udhë, iu afrua plazhit të Povelçit. Që aty deti i dukej si një cipë madhështore, që sa vinte e zgjatej pa mbarim deri atje, ku qielli përkulte vellon e kaltërt e puthej me të duke formuar kështu një kuti gjigande me ngjyrë manushaqe, brenda së cilës rrëshqiste pa kuptuar dielli verbonjë.

Kur u sos, pelën e lidhi në një degë dëllinje ndën

hijen e një marine të madhe. Pastaj, i zëmëruar, gjithë egërsi hipi mbi një bës... Po i vinte çudi «është apo s'është ky vendi i besëve, që pashë në muajin e kaluar. Atë ditë s'më zuri syri tërë këto ndërtesa».

Plaku filloi të numërojë me gisht barakat e gjata, që i ngjanin së largu me stallat e kooperativës. Pas çative me tjegulla, që ngriheshin mbi mure tulle, vinin ca prej dërrase dhe pas çative me dërrasa, ç'të shikoje... dhjetëra e dhjetëra kasolle, terina me kashtë, tenda e çadra me forma të ndryshme. Daja, që rrinte më këmbë majë bësit si cfurk i ngulur me kokë poshtë, foli me shastisje:

— Zot na ruaj, paska rrjedhur gjindja e Fierit këtu! S'më kanë lënë bësët të shikoja atë ditë, se ikja buzë detit.


Kur zbriti nga kodra me rërë, u gjend para një verriu. Atje po pushonin kooperativistët e «Apolonisë». Ligështirë i erdhi sapo i pa vajzat e tyre me kostume banje. Ata, që e panë të zemëruar, folën me shpoti. Plaku në fillim i duroi rromuzet e tyre, por më vonë s'e përmbajti veten:

— S'kini turp të turpërohu ju! U bëtë mostër, u veshët kështu si i mallëkuari dhe i bëtë për vete dhe ata syplasurit tanë.

— Paske ardhur i nxehur dajë. — Po xha Kozmai nuk e la ta mbaronte fjalën pojanakun.

— Mori ç't'i bëj që s'ndodhi kjo kockë, pa të kisha qenë unë? As çupën as mbesën nuk do të m'i shihte kush këtu.

Plaku ecte rëndë - rëndë si kompas ugari e vërentë detin, që shtrihej përpara sa s'ta zinte syri. Tek shikonte ata njerëz shtrirë në rërë, iu prish mendja dhe po i vinte takija rrotull. Zemra e tij prej të



vjetri, u hodh sikur e shpoi ndonjë gjemb, uli kokën e kërrusi shpinën. Dielli qe ngritur në kupë të qiellit. Dajë Kozmai në mes të vapës me takijen majë koke ecte dhe shikonte. Pa pritur u ndodh para një vadhi me njerëz. Ishin fshatarët e tij. Aty mes shoqeve ishte dhe e bija. Kur e pa ashtu gjysmë të zhveshur, «si të mallëkuar», i erdhi një mendim që ta kapte për flokësh e t'ia epte shpirtin në dorë. Ta bënte usta në mes atyre njerëzve, sa të falej për shën - Mark.

Tek ecte më dy më dy, pa dhe kryetarin e lokalitetit.

— «Po kur qenka bërë dhe ky me të shoqen si larkneshi, s'i ngel gjë vajzë sime» — mendoi me vete.

Vajzat e reja që e panë dajën u bënë kokërr meli, kurse disa djem i vajtën pas dhe e pyetën pse qe munduar. Ai i vërejti ata «lakuriqët» me bisht të syrit e u tha:

— Erdha për të parë si shitet bostani, meqë do të sjellë dhe kooperativa jonë...

FJALOR:

bës = pirq rëre i madh.

laresh, stomeq = zogj korijesh

jamruk = bimë e tokës gripore.

ngjacoj = e lidhi (lopën) me litar të gjatë

ovrad = ana e ugarit, që s'punohet dot

mëzonte = thuhet atëhere, kur viçi lëpin gjithë e lopës, që t'i vijë qumështi.

marinë = bimë me krende (dru i madh)

kompas ugar = vegla e normistit, që mat ugarin (i thonë dhe këmbalec).



JETË E HIDHUR

KORROSAKU

Lukë Sqepari kur u rrit e vuri brisk në faqe, mendoi se ku të punonte. Së fundi e bëri mendjen top e i tha t'et:

— Nuk shkoj as hamall në Durrës, as bari në tufat e zengjinëve. Djali bëri çikës me këmje e gjuante nëpër kënetat. Pastaj, kur e mësoi mirë mjeshtërinë e peshkatarit, u fut si punëtor korrosak në gjolin që kishte marrë iltizam Peço Poçari, njeri me dhëmbë në qytet e me pasuri në fshat.

Bashkë me gjolin e Kërrnicës e pyllin e Poros, Peço Poçari kishte marrë iltizam gjithë çmbante meraja verore prej Boçove deri në Apolloni. Në këto vende gjysmë të shkreta, ku shkelte rrallë këmba e njeriut, zoti Peço nxirrte fitime. Për këtë çiflig të papunuar, që ishte i hapur sa s'ta zinte syri, zotnia paguante pak. Siç dukej njerëzit e qeverisë nuk e dinin se sa para nxirrte nga peshku i verës e i dimrit në gjolin e Kërrnicës, s'e dinin se ç'të ardhura kishte pylli i Povelçës e i Poros. Atyre as u kishte shkuar në mendje se dhe nga kënetat e kripur e Loçanit Peçua nxirrte fitime me majë.

Vërtetë me ujë të qelbur rrinte kënetat e Laçanit deri në gusht, po kur vapa e verës mbërrinte kulmin, ajo thahej e nga ujët e saj pocaqi dilte kripë e bardhë.

Pa një bekçi të zotin ku bënte dot Peçua. Kër-koi e kërkoi dhe e gjeti Latif Laron, kushërinë e Ali Mustaqes, që ishte qehajai i Qemal Beut. Latif Larua qe trim i këmbëzës, por si njeri i rritur në malësi, s'kishte mësuar as not, as të ngiste lundrën.

— Po hëse ja del në krye Latifi — kishte thënë Peçua — pse do t'i gjej menxerin unë.

Kënetën e Laçanit, që nga Povelça në Hoxharë të gjithë e truanin se ajo ishte foleja e shejtanëve dhe e laçovet. Këtë gjë e dinin dhe shenjtorët lart, prandaj e kishin rrethuar këtë vend të mallëkuar me kisha: nga perëndimi shëne - Premtja, nga lindja shën - Maria dhe në të dy anët e tjera shën - Kolli e shën - Pjetri.

Po sado vend i truajtur prej perëndisë e prej njeriut, Laçani u epte një pasuri myzeqarëve në muajt e verës, kripën e bardhë si ajkë mbi llogaçe.

Atë vit, kur erdhi bekçi Latif Larua, u bë kripa pa masë. Gëzonin soparakët e gjithë fshatarët për-reth.

Barinjte që kullosnin bagëtinë nga çolet përzier me jamruk e shikonin të parët bardhësinë e kripës.

— U bë kripa — thanë pelarët.

— U bë kripa — thanë më tëhu kënetës loparët te çolet.

— U bë kripa — thanë më tëhu akoma dhena-rët te çai-ret djerr.

— U bë kripa — thanë pularët përmes marina-vet anës kënetës.

Dhe lajmi gojë më gojë shkante deri brenda në fshat. Fjala se ishte bërë kripa mbushte me gëzim zemrat e fshatarëve, sikur kokrrat e kripës të qenë kokrradrithi, kokrra floriri.

Ishte ditë e nxehtë vere dhe fshatarët po nise-
shin për të mbledhur kripë me dorë në shportë dhe
druajtje në zemër. Po ecnin soparakët e shkretë si
varfanjakë me këmbë të z bathura e të grisura nga
thereckat, të shpuara nga zhukat e drizat. Ata iknin
mbi tokën shëllirë plasra - plasra me nxitim, për të
mbërritur sa më shpejt te kripa, që zbardhonte si
pëlhurë në kënetë.

Në anën tjetër, nga fundi i kënetës së Laçanit,
Lafif Larua përgjonte mbi një bës rëror në formë
mullari. Kur ndezi çibukun, sytë i vajtën përpara,
shumë thellë ngā cepi i shteruar i kënetës së Laçanit.
I bëhej se atje në cepin e Sopit, afër Boçovës kishte
hije të holla që zgjateshin nga avujt e vapës.

— Me siguri janë njerëz që mbledhin kripë. . .

Dhe sa më shumë që ky mendim ja përshkonte
trutë, aq më tepër i qeshte buza, aq më tepër i ha-
pte sytë. Një gëzim i turbulluar po e ngacmonte për-
brenda dhe e bënte të thithte më shumë çibukun.
Përmes reve të vogla të tymit të duhanit beqiu
përfytyronte më kënaqësi sikur kishte gjetur në
kripë fshatarët, i kishte zënë me presh në dorë, ua
kishte hedhur në qafë thasët e mbushur dhe i kishte
vënë përpara si gomarë të ngarkuar për në komune.

Atje do t'ua epte në dorëzim xhandarëve. Pa
do të vinte kryetari i komunes! Pa le kur t'ua vinin
dy këmbët në një opingë atyre fshatarëve hajdutë.
Emri i Latifit do të bëhej i nderuar. Të gjithë do të
flisnin për trimërinë e tij. E ja, kur të shihje që ta
thërrisnin në qytet e t'i thoshin:

«Për ty, o Latif Laro kemi nevojë, s'do ta lë-
më trimërinë tënde të humbasë andej nëpër marinat
e Laçanit. Ty do të bëjmë xhandar.»

Teksa mendonte kështu me vete, dëshira po i shtohet për të vajtur deri në atë pjesë të kënetës ku qe bërë kripa.

* * *

Llukë Sqepari në Kërrnicë këndonte mbi shtratin e peshkimit. Latif Larua zbriti nga bësi dhe i drejtua peshkatarit që merrte këngë duke fishkëllyer. Pasi e takoi në breg, e pyeti për lundrën dhe nëse dinte ta ngiste mirë. Kur po zgjidhte lundrën, Llukë i tha bekçiu:

— Ku ke për të vajtur?

— Ja — foli Latifi — te ajo anë e kënetës ku është bërë kripa.

Peshkatar i bëri sikur u mendua.

— Si thua, do ta çosh lundrën deri atje?

— Do të mundohem — u dëgjua Llukë.

— Hë, se do ta shpërblej; s'do ta marr gjysmën e peshkut, që i takon zotnisë si pjesë nga malli i vet.

— Me gjithë mend?

— Po more djalë, s'e ha fjalën më dysh, më thonë Latif Laro mua. Thashë s'e dua e mbaroi.

— Prit një minutë sa të hedh trastën me peshk në krahë e ta lidh mirë — tha Llukë Sqepari.

Të dy u nisën me lundër përmes kënetës së Laçanit për në cepin e Boçovës, ku dukej kripa si petë dëbore. Lundra si koritë e gjerë ecte pa zë në ujën e rëndë. Qetësinë e natës e prishnin bretkosat, që kuakakisnin dhe çakenjtë që aullinin pyllit.

Në fillim lundra rrëshqiste pa frikë, po kur u futën në thellësi, ajo sikur rrëshqiste me droje. Bekçiu u tremb pak dhe për t'u siguruar një çikë e pyeti djaloshin:

— Ke ngarë herë tjetër lundër ti, çun?

— Posi s'kam ngarë. Dhe në dimër, bile dhe në Kërrnicë kam lundruar.

— Po si të quajnë ty?

Djaloshi bëri sikur s'dëgjoi, i dha lundrës me fuqi me koll dhe e bëri që të dridhet pak.

— Ngadalë more kokëshkretë, desh na vithise!

— Mos ki frikë, Latif aga — thoshte peshkatari.

— Si të quajnë ty? — përsëriti bekçiu.

— Eh? Çfarë the? — thoshte djali.

— Si të quajnë, more i paudhë?

— Aha, si më quajnë? Më quajnë Korrosak, Korrosak Lundra.

Kur sosën në mes të udhës, Lluka pyeti bekçiun.

— Pse do të shkosh në Boçovë, zotrote?

— Se ashtu duhet. Nuk di ti se ç'ndodh kur bëhet kripa! Fshatarët janë njerëz të zijosur dhe shkojnë dhe e mbledhin si të babëzitur, pa pyetur në ka zot ky mall, apo jo.

— Nuk e besoj, Latif Aga.

— Nuk e beson ti, po kjo është e vërtetë. Janë mësuar me vjetet e kaluara ata maskarenj. Atëhere s'kishte bekçi për të qenë. Po tashti do t'ua rregulloj unë samarin.

— Njerëzit e këtyre anëve kanë namustër, rroj-në me nder, nuk vjedhin, Latif Aga.

— E, more i paudhë, dhe vetë je nga këta, po s'ma hedh dot mua, jo. Fshatarët janë dreqër, dreqër me brirë.

— Pse e kujton dreqin? Apo pse po udhëtojmë te shtëpia e djajvet.

Bekçiu heshti. Lundërtari pyeti:



— A e ke parë ndonjëherë djallin zotrote, kur ai del për t'u larë?

— Jo. Pse ti e ke parë? — foli me çudi Latifi.

— Si s'e kam parë! S'ka javë që nuk shoh dreqër. Këtu është vendi i largneshit, pse i thonë Laçan.

— Ashtu?!

— Pse thashë të mos truej.

— E po më shpëtoi!

— Që ta marrësh vesh zotrote... aqë duan laçot këtu në mes të ujit. Ata dhe pa thirrur e pa truar vijnë vetë. Nuk e dini ju, Latif Aga, se djajtë e kënetës nuk flenë natën? Apo s'po udhëtojmë mbi shtëpinë e tyre!

— Pa më thuaj: si e pe ti atë djallin, që t'u shfaq?

— Cilin? se unë të thashë s'kam parë një djall, Ohu... sa shejtanër më janë shfaqur mua!

— E po si de, si të shfaqen?

— Qysh të qëllojë. Ja, para ca kohe udhëtoja një herë natën, tamam në këtë vend dhe kur do ti të më fanepset një hije, pastaj si njeri me brirë dhe me bisht, unë e shava (se shejtani duhet sharë gjithnjë). Ai ndërroi fytyrë dhe m'u bë si gomar, pastaj si pulisht, dhe më pas krraç i vogël fare e me veshë të gjatë... aman o zot sa u tremba!! Pastaj u këthe si vajzë e deshte të më joshte, po unë s'pyesja e ngisja lundrën fort, fort dhe dola më së fundi.

— A u trembe?

— Unë të trembem! Nga shejtani!... s'e dha zoti.

— Çudi jini ju peshkatarët! Si s'trembeni fare nga dreqi?!

Llukë Sqepari e pyeti pastaj bekçiun:

— Ç'do t'u bëni atyre që do të gjeni duke

mbledhur kripë?

— Do t'i bëj që të venë mend.

Lundra rrëshqiste mbi ujë në afro një metër e gjysmë thellësi. Korrosaku mendonte me vete: Ah, qen i biri i qenit! shkon t'iu bjerë në qafë njerëzve të pafaj. Kush e di atje mund të jenë edhe tim vëllezër, e ky qerrata vete e ua sjell në majë të hundës... Po jo, jo, s'do ta lë të thatë. Kur korrosaku po mendonte kështu duke lëvizur kollin, beqçiu tha:

— Mo ç'më shohin ashtu sytë!?

— Nga? — i foli fort lundërtari.

— E mo, po ja, përpara.

— Shët! — ia bëri Lluka, — akoma s'e kupton. Është vetë largneshi.

Korrosaku e ndërroi drejtimin e lundrës, andej nga ishte një marinë një metër e ca e lartë mbi ujë, që ngjante si hije e frikshme djalli.

— Qenke këmbë ters Latif Aga... Ja, tjetri shejtan!!! Si do të bëjmë?

Beqçiu, që vërtet s'dinte not dhe as të ngiste lundër filluan t'i dridhen gjunjët. Harroi dhe ëndrën për t'u bërë xhandar. Nja dy degë marine të cala anash i bëheshin veshë prej të mallëkuari dhe dy të tjera i dukeshin krahë. Lluka bëri që lundra të binte mbi degët e marinës, pastaj me zë si klithmë bërtiti:

— Na rrëmbeu shejtani! - Shpëto kokën Latif Aga.

Korrosaku po notonte me të mbathura siç qe, me trastën me peshk hedhur krahëve, kurse beqçiu rrinte i mbajtur në të dy anët e koritës. Lundra po lëpinte ujë, kollin e kishte flakur Lluka tutje. Latif Larua zbriti në ujë, pushkën e mbante në duar. Fishkët iu qullën dhe manxerri i mori të lagur qysh

më çapat e para që bënte gjithë tronditje.

— Obobo Korrosak!! Obobo!

Lluka bërtiste nga ana e tij. — E pe! ç'na bëri shejtani?! E pe?

— E pashë, e pashë, por s'po shoh si do të dalim.

— Latif Aga, shejtani ka frikë nga zjarri, prandaj shtjerë me dyfek.

— Do të tallesh, po s'i shikon fishekët dhe pushkën si janë lagur nga ujët?!

— Provoje, provoje, — thoshte Lluka dhe mezi e mbante të qeshurit.

Latif Larua me ato mend, krodhi duart në ujë, hoqi një vezme me fishekë në brez dhe e vuri në grykën e pushkës. Mori të shtinte dhe ajo nuk zbrazej. Kur pushka nuk po shkrepej, korrosaku e pa të plotë fitoren.

— Hajde pas meje Latif Aga, mos ki frikë, tutje është më cekët; po ruhu nga shejtanët. Lluka ecte duke notuar, e s'e hante merakun për lundrën, e njihte vendin me pëllëmbë. Lundërtari ecte me not pa droje, bekçiu i shkonte prapa më këmbë gjysmë i vdekur, duke bërtitur me zë gjysmë lutës e pa turp.

— Aman korrosak, mos ikë shumë larg meje. Po Llukë Sqepari e bëri të tijën. Si u largua në errësirën e natës, ai i foli fort bekçiu:

— Nuk më quajnë Korrosak jo, nuk më quajnë Korrosak. Në pellgun e cekët Lluka ikte më këmbë. Ai ecte shpejt. E pse të mos nxitonte! Apo do t'i rëndonin rrobat! Me nder, vetëm në të mbathurat që. Me të mbërritur te vendi ku njerëzit mbledhnin kripë gjeti fshatarët e vet. U kallëzoi ç'i kishte ndodhur me bekçinë e u largua bashkë me ta për në Sōp.

Lili e nëna e tij, Maria, u gdhinë të qeshur ditën e pazarit. Lili qe gëzuar së e kishte mbaruar së thururi rrogozin e dytë. Ai ishte i kënaqur edhe pse e ëma i pat thënë: «Me paratë e dy rrogozave të tu të parë do të blej një këmishë dhe një palë pantallona për ty». Nëna, e cila kishte mbetur e ve me dy fëmijë të vegjël, ishte dhe më e gëzuar atë ditë paze, sepse djali i madh iu rrit dhe po i vinte në ndihmë për të nxjerrë kafshatën e gojës.

Kur dielli e hapi syrin verbonjë në majën e Tomorrit dhe i shpërndau rrezet në gjithë Myzeqenë, Maria i tha të birit:

— Lili, ec të lidhim rrokotë të dy rrogozat. Do të nisem për t'i shitur.

Si i rregulluan mirë, Lili e ndihmoi nënën për t'i mbajtur duke e përcjellë deri tek rruga kryq.

— Ki kujdes — i tha ajo djalit dhe e puthi — kujdes të mos lodhesh shumë, sepse kemi ngrënë bukë gruri me egjër.

— Mos u bëj merak — i tha i biri e iku duke flutuar nga gëzimi. Kështu ata u ndanë të shoqëruar nga ëndrrat e bukura për të ardhmen. Nëna me rrogozat në krah mori rrugën për në pazar dhe Lili me drapër në dorë u nis nga kënetat me kashtë.



Maria, tek e shikonte të birin nga pas, nuk u zinte besë syve që djali i saj tashti që rritur, mund të korrte kashtë me palcë e të bënte rrogoza. Drejtoi sytë nga ugari, nga toka e paktë; me shikimin e saj sikur deshte t'i thoshte tokës se po i shtoheshin krahët e punës, se do ta shporrte varfërinë.

Kur doli në rrugën kryesore, pa beun që po kthehej nga gjahu i pëllumbave me çiften hedhur krahëve.

— «He, o gjarpër i keq — tha me vete — varfërinë dhe gjithë të këqiat ti na i sjell në fshat. E gjeç nga mos e shprefsh — mallëkoi Maria duke ikur pa shikuar anës.



Lili, me të mbërritur në kënetë, zuri të gjëllijë se ku kishte kashtë më shumë e më të mirë. Kur mori të futej në ujët e kënetës, iu muar mendja, i vinte ligsht nga goja, këmbët i dridheshin.

« — Ç'është kjo kështu? — tha me vete — S'më ka ndodhur një gjë e tillë ndonjëherë. Djaloshi harroi ç'e porositi Maria. Atij nga gëzimi i këmishës dhe i pantallonave të reja, që do t'ja binte e ëma prej qyteti, i doli nga mendja se një ditë më parë bleu grurë me egjër te subashi. Ngaqë trupi po i dridhej, djaloshi shkoi u shtri në hijen e një marine. Ndenji atje një copë herë dhe si e mori pak veten, u ngrit. Hodhi sytë në kënetë e pa se pas ca zhukave të egra dukej kashta e verdhë. U nis për atje. Kur mbërriti, vuri re se kashta s'bënte për rrogoza, sepse ishte pirrë dhe jo kashtë me palcë,

që i thonë kashtë fryjtje. Më kot u lodh Lili një orë, dy, duke rendur nëpër kënetë. Mirëpo ja... kërko e kërko derisa i doli përpara një ngastër me asi kashte siç e donte.

«— Më së fundi nuk më shkoi mundimi kot» — tha Lili. U përvesh mirë e mirë dhe u fut brenda. Kashta i pëlqeu. «Qenka e mrekullueshme — tha — e gjatë dhe me palcë të butë».

Me zemër të gëzuar e me drapër në dorë djalo-shi nisi të korrte duajt e parë. Kur po bënte sërën e dytë, ndjeu se këmbët i hanin dhe i qenë rënduar: «Ndoshta nga kallamishtet e kënetës» mendonte Lili. Mblodhi prap gjithë forcat sa e mbaroi postatin. Dhe ja, pa pritur, ndjeu përsëri të marrur mendsh e doli andej, nga ujët ishte më pak i thellë.

Me t'u ulur te rrënjët e një marine, pa se në kërcinj të këmbëve dhe në kofshë i qenë ngjitur me dhjetëra shushunje, që ngjanin si ngjala të fëlliqura, si gjarpërinj të frikshëm. Djaloshi u ngjeth nga ajo pamje llahtarie; zemra iu drodh e qielli po i vinte anës. Mori të hiqte shushunjën e parë. Ajo nga që ishte e ngopur me gjak iu bind Lilit, e hoqi turinë menjëherë, duke lënë një gjurmë të kuqe, ku filloi të dilte gjak.

Lili deshte t'i nxirrte të gjitha, po ato qenë ngulur fort e nuk shkuleshin. Kur mori të hiqte dy shushnja të vogla, u çudit. Ato u këputën, lanë turinj të brenda dhe s'dilnin. Koha s'priste, duhej vepruar shpejt, për t'i zhdukur sa më parë shushunjat nga trupi. Ndërsa ato kishin vendosur të pinin sa më tepër gjak, andaj i fushnin nofullat si venduze sa më thellë.

— Ah! Sikur të kisha me vete një shkrepëse!

Do t'i kisha përvëlur për një minutë — tha djalo-
shi. Në atë çast iu kujtuan gjëmbat e zhukës. Kë-
puti disa syresh e filloi t'i shponte shushunjat; ato
me dëshpërim po i hiqnin turinjtë, duke lënë gjith-
një të plasura si kokërriza shege në lëkurë. Nga ato
bira të buavitura buronin pastaj vija gjaku, që binin
mbi ujët e qelbur të kënetës, duke formuar shirita
fjongosh të kuqe si stoli trëndafili për moçalin. Me
anën e gjëmbave të zhukës Lili i hoqi njëra pas tje-
trës gjithë shushunjat. Pastaj djali u ngrit më kë-
mbë, mori frymë thellë e hodhi një sy anës e për-
qark, po asnjëri nuk pa. Dukeshin vetëm bretkosa,
që kuakisnin nëpër ujëra dhe lart në qiell vërejti
vargje me lejlekë, të cilët merrnin rrugët e largëta.
Ishte fundi i gushtit. « — Askush nuk mund të të
ndihmojë, o Lili » — i tha vetëvetes djaloshi.

Mblodhi atëhere përsëri gjithë fuqinë që i kishte
mbetur dhe u nis për te kasollja e barinjve. Ndonë-
se ikte shpejt, rruga s'i kishte të sosur. Sa më shumë
vraponte, aqë më tepër ndjente se i kapitej tërë tru-
pi. Kur arrijti te kasollja e barinjve loparë, ata u
lemerisën, duke e parë aqë të venitur.

— Ç'është ky gjak? — e pyetën barinjtë.

Lili nga lodhja dhe mundimi që nemitur aqë
tepër, saqë nuk shqiptonte dot fjalët, po fliste me
një gjysmë zëri të belbëzuar:

« — Shshshushunjat... » dhe mundohej të
shpjegonte me shenja ç'i kishte ndodhur. Çobani
plak nxori kutinë e duhanit e u tha të rinjve t'ja
zinin plagët Lilit me duhan. Duhani që i paktë e nuk
majftoi për të gjitha të kafshuarat e shushunjave.
Nga ana tjetër dhe plagët e mbyllura me duhan nuk
u zunë plotësisht, gjaku rridhte akoma nga pak në to.

— Sa të liga janë shushunjat e kënetës — foli një bari i vogël.

— Më të liga se këto të kënetës janë shushunjat e jetës — ja ktheu bariu plak.

— Po cilat janë këto shushunje jete? — deshi të dinte bariu djalosh.

— Eh, mor bir, je çunak, po do t'i njohësh më mirë se ç'i njeh. Janë bejlerët e tregëtarët, që na rjepin, na varfërojnë, na pinë gjakun e djersën.

* * *

Maria me paratë e rrogozave kishte blerë këmishë dhe pantallona doku. Atë vit kashta që e paktë dhe nevoja për rrogoza që e madhe, andaj dhe ata shiteshin mirë në pazar.

Me t'u futur në fshat, para se të vinte në shtëpi i vajtën sytë te selvitë e larta. Atje në mes të selvive, që shponin qiellin, ajo kishte groposur burrin e saj. Këtë herë nuk deshte të kthehej në atë vend trishtimi, nuk donte ta ngacmonte gëzimin e saj me kujtimet ngjethëse të atij vendi të përmortshëm. Maria ecte. Kur po shkonte anës rrugës, ku binin hijet e selvive të larta, iu bë një si hije, sikur iu ngrit i shoqi nga varri e i tha me zë të fortë:

— E, a nuk të thoshja unë gjithnjë, kur lëngoja: «Ti do të rrosh dhe do t'i gëzosh djemtë?»

— Vërtetë që djali i madh m'u rrit tashti, o burrë, ja e shikon! I bleva këmishë dhe pantallona me paratë e rrogozave të parë që i thuri vetë djalit të madh, Lilit.

— «Ah! ja marrtë babai gjithë të ligat! Po i thuaj që të mos harrojë të marrë hakën e babajt.

Po t'i vijë rasti le të hakmerret kundër beut, që na dëboi nga toka e na la në dheun moçalik» — Kështu foli ai e u zhduk përsëri sikur e përpiu varri i heshtur përnjëherë.

Kësaj radhe Maria kthehej nga pazari për në shtëpi me sy të kthjellët, jo me lot në sy si zakonisht. Ajo ecte përmes kopshtijeve, për të mbërritur sa më parë në shtëpi. Tek ishte duke hedhur një hendek, i vajtën sytë te Spiro Qishari, i cili shkoute udhës kryesore duke mbajtur një arkivol prej dërrase.

— «Dikush paska vdekur! Ndiija zot shpirtin — tha Maria duke bërë kryq dhe vraponte si shqipo-një për te djemtë e saj.

Një të hedhur këmbën në oborr, pa një njeri me takije të gjatë.

— «Ah, e zeza unë — murmuriti ajo — me sa duket ai do të jetë subashi. Ai do të ketë marrë vesh se shita rrogoza dhe vjen të më kërkojë paratë e grurit, paratë për grurin me egjër, që më shiti par-dje... kurse unë i bleva rroba» — kështu thoshte gruaja me vete dhe një urrejtje e madhe i lindi në zemër kundër atij që i shiti grurë me egjër.

Ngaqë i zjenin këto mendime në kokë, Maria nuk vuri re se në oborr e brenda shtëpisë kishte shumë njerëz, që rrinin të heshtur dhe mezi lëviznin.

Te pragu i shtëpisë atë e priti një plakë e mençur me zemër të fortë. Ajo i tha:

— Marie! Mos u tremb. Lilin e ke ca të sëmure, pooo...

— E zeza unë! Nga egjëri me siguri! — klithi ajo dhe u fut brenda. Me të hyrë në dhomë, djali i vogël iu hodh në qafë e i tha:

— Nëno! Zgjuaje Lilin! Do të shkojmë të marrim patat.

Maria, kur pa të birin të shtrirë me fytyrë të zbetë, ku i dukej një buzëqeshje e ngrirë, dha kujen me lemeri, sikur vërtetë do ta zgjonte djalin.

— Lili! — Ngreu, shiko rrobat e reja! Shpirti i nënës, ngreu!

Por Lili heshte.

I shtrirë, me buzëqeshjen e ngrirë dhe me njerin sy gjysmë të hapur dukej se thoshte: «I shoh nënë, i shoh, po mos u mërzhit, ruaji për vëllanë e vogël.»

— Ngreu, o shpresë e nënës! Ngreu, o bir! — thërriste e lebetitej Maria. Po Lili s'përgjigjej. Ai kishte vdekur një orë më parë.

PASQYR E LËNDËS

MOTIVE TË REJA

Gjoli rosave	Faqe 5
Davidhi	» 19
Demi larush	» 28
Kristina	» 37
I fundit	» 51
Llaz Pendari	» 64
Taqi dredhaqi	» 74
Në plazhin e Povelcit	» 86

JETË E HIDHUR

Korrosaku	» 95
Lili	» 104

TIP 14

LIBRARIJA E SHTETIT
DIPLOMATIKE

Tirazh: 5000 kopje Format 70x100/32 Stash: 2204-65

Shtyp. N.I.Sh. Shtypshkronjave «Mihal Duris» — Tiranë, 1969